

KORNIZË PËR
E D U K I M
M E D I A T I K
N Ë A R S I M I N
F I L L O R

2023, Shkup



KORNIZË PËR EDUKIM MEDIATIK NË ARSIMIN FILLOR

Kjo kornizë u përgatit prej grupit të punës i përbërë nga përfaqësues nga Byroja për Zhvillimin e Arsimit, IREX dhe Instituti Maqedonas për Media.



Ky dokument është realizuar në kuadër të Projektit të USAID-it për edukim mediatik "Të rinjtë mendojnë" i zbatuar nga IREX së bashku me Institutin Maqedonas për Media (IMM), Institutin për Studime të Komunikimit (ISK) dhe Forumin Arsimor Rinor (FAR) në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Byronë për Zhvillimin e Arsimit dhe Qendrën Shtetërore të Provimeve.

Dokumenti është mundësuar me mbështetjen e popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përbajtja është përgjegjësi e IREX-it dhe Institutit Maqedonas për Media (IMM) dhe nuk shpreh pikëpamjet e USAID-it ose Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

PËRMBAJTJA

1 HYRJE	4
1.1. Çfarë paraqet edukimi mediatik	4
1.2. Nevoja për inkorporimin e edukimit mediatik në arsimin fillor	6
2 BAZAT THEMELORE PËR PËRFSHIRJEN E EDUKIMIT MEDIATIK NË ARSIM	8
2.1. Shqyrtimi i dokumenteve dhe rekomandimeve ndërkombëtare	9
2.2. Përfaqësimi i edukimit mediatik në sistemet arsimore të vendeve të tjera	13
2.3. Edukimi mediatik në sistemin arsimor të Republikës së Maqedonisë së Veriut	14
2.4. Hulumtime dhe rekomandime për edukimin mediatik	16
3 KOMPETENCAT PËR EDUKIM MEDIATIK NË STANDARDET KOMBËTARE PËR ARSIMIN FILLOR	18
3.1. Standardet kombëtare në arsimin fillor	18
4 EDUKIMI MEDIATIK NË PROGRAMET MËSIMORE	21
4.1. Edukimi mediatik si temë e veçantë në lëndët gjuha maqedonase, gjuha shqipe, gjuha turke, gjuha serbe dhe gjuha boshnjake	22
4.2. Edukimi mediatik si temë e veçantë në Arsimin teknik dhe informatikë	32
4.3. Edukimi mediatik në aktivitetet për arritjen e rezultateve të nxënimit në lëndë të ndryshme	33
4.4. Edukimi mediatik përmes lëndëve zgjedhore	36
5 KOMPETENCAT E MËSIMDHËNËSVE PËR ZHVILLIMIN E EDUKIMIT MEDIATIK MIDIS NXËNËSVE	37

1

HYRJE

1.1. ÇFARË PARAQET EDUKIMI MEDIATIK

Përkufizimi më i pranuar i edukimit mediatik e përkufizon si **aftësi për qasje në media, për të analizuar, vlerësuar dhe krijuar përmbajtje mediatike dhe për të vepruar duke përdorur të gjitha format e komunikimit**. Termi edukim mediatik përfshin dy terma: media dhe edukim. Me media nënkuptohen të gjitha mjetet elektronike ose digjitale dhe të gjitha përmbajtjet të shtypura dhe artistike vizuale që përdoren për të përcjellë informacione ose mesazhe tek një audiencë e madhe. Edukimi paraqet aftësinë për të koduar dhe deshifruar simbolet dhe për të sintetizuar dhe analizuar mesazhet. Së këndejmi, rezulton se edukimi mediatik është **aftësi për të koduar dhe deshifruar simbolet e transmetuara përmes mediave dhe për të sintetizuar, analizuar dhe prodhuar mesazhe mediatike në forma të ndryshme**.¹

1 Shoqata Kombëtare për Arsim për edukim mediatik. (National Association for Media Literacy Education). [<https://namle.net/resources/media-literacy-defined/>].

Në kushtet moderne, njerëzit bombardohen gjithnjë e më shumë nga të gjitha anët me përmbajtje informative, argëtuese dhe edukative, të cilat transmetojnë informacione duke përdorur kombinime fjalësh, imazhe dhe tinguj që prekin të gjitha shqisat, duke ndikuar në mendimet dhe ndjenjat, si dhe në mënyrën e të menduarit dhe sjelljes. Prandaj, për të qenë një nxënës i suksesshëm, qytetar i përgjegjshëm ose punëtor produktiv, nevojiten kompetenca për përdorimin "me mençuri" të informacioneve nga të gjitha mediat e pranishme. Për këtë, është e nevojshme të zhvillohet aftësi të cilat do t'u ndihmojnë të kuptojnë mesazhet dhe të përdorin me sukses të gjitha mjetet në dispozicion të tyre për të krijuar dhe dërguar mesazhet e tyre. Me fjalë të tjera, të jesh i edukuar në epokën digjitale në të cilën sundojnë mediat, do të thotë të zotërosh aftësi të të menduarit kritik që jo vetëm mundësojnë përdorimin dhe krijimin e duhur të mesazheve mediatike, por gjithashtu ndihmojnë në marrjen e vendimeve përkatëse dhe të përgjegjshme në të gjitha situatat e tjera të jetës së përditshme.

Nga arsimi për edukim mediatik pritet t'i pajisë nxënësit të kenë qasje në media, të analizojnë mesazhet dhe të vlerësojnë informacionin që marrin, të krijojnë vetë mesazhet mediatike dhe të veprojnë, përkatësisht të përdorin informacionin që marrin përmes mediave në mënyrë të sigurt dhe të përgjegjshme.² Kjo do të thotë që gjatë procesit arsimor, nxënësit duhet të mësojnë se si të kenë **qasje** në media për të pasur qasje në larmi informacionesh, por edhe për të fituar aftësi digjitale në mënyrë që ata të mund të përdorin në mënyrë efektive mediat dhe aplikacionet mediatike, të cilat vazhdimisht ndryshojnë dhe azhurnohen.

2 Shkolla e lartë për gazetari dhe marrëdhënie me publikun (2018). *Manual për edukim mediatik për të rinjtë, mediat dhe organizatat e shoqërisë civile*. [https://www.medium.edu.mk/attach/Pripracnik-za-mediumska-pismenost-MK.pdf?5c1a6b78].

Pasi nxënësit të mësojnë të kenë qasje në përmbajtje mediatike, ata duhet të fitojnë aftësi për **analizimin** e mesazheve mediatike. Analiza në të vërtetë jep një përgjigje për pyetjet e mëposhtme:³

1. Kush e ka krijuar mesazhin?

Ndihmon nxënësit të mësojnë se të gjitha mesazhet janë ndërtuar me një qëllim të caktuar dhe janë rezultat i zgjedhjes së bërë nga autori/ët, prandaj është e nevojshme ato të shihen me një sy kritik.

2. Cilat teknika janë përdorur për tërheqjen e vëmendjes?

Duke eksploruar formatin e mesazhit mediatik, mënyrën e ndërtimit të tij dhe komponentët (fjalët, muzika, ngjyrat, lëvizjet, këndi i incizimit, etj.) që përdoren për të kompozuar atë mesazh, nxënësit mësojnë se si mesazhi arrin qëllimin e dëshiruar.

3. Në çfarë mënyra të tjera mund të kuptohet mesazhi?

Kjo u lejon nxënësve të mësojnë se njerëzit dallojnë sipas besimeve, interesave dhe përvojave. Interpretojnë të njëjtin mesazh në mënyra të ndryshe, ndërsa njerëzit që janë më të ngjashëm kanë më shumë gjasa ta kuptojnë mesazhin në mënyrë të ngjashme.

4. Cilat vlera dhe pikëpamje përfaqësohen në mesazh dhe cilat anashkalohen?

Ndihmon nxënësit të mësojnë se zgjedhjet që bëjnë autorët kur ndërtojnë një mesazh pasqyrojnë vlera, qëndrime dhe pikëpamje të caktuara. Ndonjëherë media mund të jetë e pakujdesshme dhe të krijojë dhe/ose të mbështesë stereotipe, në vend që të përpiqet për një transmetim të drejtë dhe të ekuilibruar të ideve dhe pikëpamjeve të ndryshme.

3 Center for Media Literacy (2005). *Media Kit*. [https://www.medialit.org/sites/default/files/14B_CCKQPoster+5essays.pdf]

5. Pse është dërguar mesazhi?

Duke përcaktuar se kush kontrollon krijimin dhe transmetimin e mesazhit, qëllimi përfundimtar i të cilit është më së shpeshti të realizojë fitim ose të fitojë pushtet, nxënësit mësojnë të zbulojnë se cili është publiku i synuar që duhet të pranojë mesazhin, të njohin përmbajtjen propagandistike dhe manipuluese, të kontrollojnë kush përfiton nga ajo që përcjell mesazhi dhe të dallojnë informacionin e besueshëm nga ai i rremë, manipulues dhe keqdashës.⁴

Përveç analizimit të mesazheve, është me rëndësi thelbësore që nxënësit të mësojnë dhe **vlerësojnë** në mënyrë kritike përmbajtjen e tyre. Kjo do t'u ndihmojë të njohin nëse informacioni i dhënë në mesazh është i vërtetë apo i rremë, nëse është lajm profesional apo manipulim, nëse është objektiv apo i njëanshëm. Vlerësimi kritik i përmbajtjes mediatike bëhet në drejtim të katër dimensioneve:

- 1. Rëndësia:** A është dhe sa i rëndësishëm është informacioni për qëllimin për të cilin duhet të përdoret?
- 2. Saktësia:** Në çfarë mase informacioni përmban detaje faktike dhe të përditësuara që mund të verifikohen përmes burimeve alternative ose parësore ose duhet të konsiderohen të rreme?
- 3. Njëanshmëri:** Nga cili pozicion e ka formësuar autori informacionin? A vërehet se përmbajtja e lajmit mban anën e dikujt?
- 4. Besueshmëri:** Sa i besueshëm mund të jetë informacioni bazuar në shkallën e besimit që gëzon autori, përkatësisht transmetuesi i informacionit.⁵

4 Center for Media Literacy (2005). *Media Kit*. [https://www.medialit.org/sites/default/files/14B_CCKQPoster+5essays.pdf].

5 Coiro, J. (2017). *Teaching Adolescents How to Evaluate the Quality of Online Information*. Edutopia website. [https://www.edutopia.org/blog/evaluating-quality-of-online-info-julie-coiro].

Një tjetër korpus aftësish të fituara përmes arsimit për edukim mediatik i referohet **krijimit** të mesazheve dhe përmbajtjes mediatike që bën të mundur përdorimin e hapësirës digjitale për shkëmbimin e informacioneve. Shkakët kryesore të trendit në rritje për përdorimin e mediave sociale mund të gjenden në nevojën psikologjike të njerëzve për të marrë konfirmimin social, për të zhvilluar dhe ushqyer marrëdhëniet me njerëzit e tjerë, për argëtim, por edhe për mbështetje për idetë, qëndrimet dhe besimet e tyre. Çelësi i komunikimit efektiv është aftësia për të njohur këndvështrimin personal, për ta shprehur atë në mënyrë të saktë, të qartë dhe të përshtatshme, me kuptimin e plotë se mesazhet e shprehura kanë ndikim.

Një segment i veçantë i arsimit për edukim mediatik është **veprimi**, përkatësisht përdorimi i informacionit të pranuar përmes mediave për të marrë vendime dhe për të ndërmarrë veprimet e duhura. Fitimi i aftësive për analizimin dhe vlerësimin e mesazheve dhe përmbajtjes mediatike hap rrugën për fuqizimin e nxënësve për të marrë vendime të përshtatshme dhe të përgjegjshme që mund të kenë pasoja për individin, i cili vendos në bazë të mesazheve dhe informacionit të përcjella përmes mediave, por gjithashtu mund të ketë ndikim mbi grupet shoqërore të cilave u përket dhe në segmente më të gjera të jetës shoqërore.

1.2. NEVOJA PËR INKORPORIMIN E EDUKIMIT MEDIATIK NË ARSIMIN FILLOR

Në vendin tonë vëmendje të veçantë për edukimin mediatik iu kushtua për herë të parë në Draft Strategjinë për zhvillimin e veprimtarisë radiodifuzive në Republikën e Maqedonisë së Veriut

për periudhën 2013-2017.⁶ Dokumenti thekson qartë nevojën për promovimin e edukimit mediatic si interesin më të madh të shoqërisë maqedonase dhe përfshirjen e institucioneve në sigurimin në arsimin formal të edukimit mediatic. Strategjia rregullatore për zhvillimin e veprimtarisë radio-difuzive në Republikën e Maqedonisë së Veriut për periudhën 2017-2023 ndjek të njëjtat angazhime.⁷

Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale 2021 thekson⁸ detyrën e Agjencisë për shërbime audio dhe audiovizuale të inkurajojë edukimin mediatic duke bashkëpunuar edhe me institucionet arsimore. Gjithashtu, Radiotelevizioni i Maqedonisë (RTVM) ka detyrim ligjor të krijojë dhe transmetojë programe në lidhje me inkurajimin e edukimit mediatic. Në kontekstin që media gjithashtu ka rol arsimor (përveç informimit dhe argëtimit), shërbimi publik në vitet e kaluara transmeton përmbajtje arsimore, promovuese dhe informuese në lidhje me edukimin mediatic të destinuar për nxënësit, të rinjtë dhe audiencën më të gjerë, të cilën e realizon në bashkëpunim me institucionet arsimore dhe sektorin civil.

Në dokumentet dhe ligjet e rëndësishme profesionale në lidhje me arsimin, nuk ka pjesë të veçanta në lidhje me nevojën ose mënyrat e aplikimit të edukimit mediatic. Në programet mësimore për gjuhë amtare (gjuha maqedonase, gjuha shqipe, gjuha turke dhe gjuha serbe) për arsimin fillor dhe të mesëm, deri më tani ka pasur qëllime dhe përmbajtje për “edukim mediatic”, por ato janë, në realitet, më shumë përmbajtje për kulturën mediatike dhe nuk janë në kontekstin e të kuptuarit modern të edukimit mediatic.

6 AshMAA (2013). *Draft strategjia për zhvillimin e aktivitetit radiodifuziv në Republikën e Maqedonisë së Veriut për periudhën 2013-2017*. [<https://avmu.mk/wp-content/uploads/2017/05/Predlog-Strategjia-i-Akciski-plan.pdf>].

7 AshMAA (2019). *Strategjia rregullatore për zhvillimin e veprimtarisë radiodifuzive në Republikën e Maqedonisë së Veriut për periudhën 2017-2023*. [http://avmu.mk/files/1_predllog_strategjia.pdf].

8 Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë (2013). *Ligji për shërbimet mediatike audio dhe audiovizuale*. [<https://praksis.mk/>].

“Strategjia për Zhvillimin e Arsimit për vitet 2018-2025 dhe Plani i Veprimit”⁹ vetëm përmend *edukimin infromativ*.

Reformat në arsimin fillor, të nisura në vitin 2020, prezantojnë për herë të parë edukimin mediatic në dokumentet që janë baza e reformës, përkatësisht në Standardet Kombëtare për Arritjet e Nxënësve në fund të arsimit fillor. Shumica e kompetencave që lidhen me edukimin mediatic mund të njihen në fushat e Edukimit gjuhësor dhe Edukimit digjital.

Standardet kombëtare më pas përkthehen në rezultatet e të nxënit dhe standardet e vlerësimit në programet mësimore në lëndë individuale. Në suazat e lëndës mësimore të gjuhës amtare (gjuha maqedonase, gjuha shqipe, gjuha turke, gjuha serbe dhe gjuha boshnjake), edukimi mediatic përfshihet nga klasa e parë deri në klasën e nëntë si një temë e veçantë dhe mund të gjendet përmes standardeve dhe aktiviteteve të ndryshme në lëndë të tjera. Ndryshimet në metodat e mësimdhënies dhe në qasjen e mësimdhënies në përgjithësi, që rrjedhin nga Koncepti për arsimin fillor, kërkojnë nevojën¹⁰ e zhvillimit të mendimit kritik midis nxënësve dhe në të njëjtën kohë bazohen në krijimin dhe përdorimin e përmbajtjes mediatike në realizmin e programeve mësimore. Në kuadër të lëndëve zgjedhore, ekziston një hapësirë e gjerë për zhvillimin e lëndëve mësimore në fushën e edukimit mediatic.

Sipas rekomandimeve të dokumenteve ndërkombëtare si dhe në përputhje me politikat arsimore në vendin tonë, procesi i futjes së arsimit për edukim mediatic në shkolla ndiqet nga forcimi i kompetencave të mësimdhënësve përmes trajnimeve për mësimdhënësit që zhvillojnë mësim sipas programeve të tyre mësimore të reja, që prezantohen në përputhje me dinamikën e zbatimit të Konceptit të ri për arsimin fillor.

9 MASH (2018). *Strategjia për Zhvillimin e arsimit 2018-2025*. [<https://mon.gov.mk/page/?id=2048>].

10 Byroja për Zhvillimin e Arsimit (2021). *Koncepti për arsim fillor*. [<https://mon.gov.mk/stored/document/Koncepcija%20MK.pdf>].

2

BAZAT THEMELORE PËR PËRFSHIRJEN E EDUKIMIT MEDIATIK NË ARSIM

Njohja e rëndësisë së edukimit mediatik dhe nevoja për ta përfshirë atë në programet për arsimin e të rinjve ndodhi në mesin e shekullit të 20-të. Dokumenti i parë që rekomandon përfshirjen e edukimit mediatik në arsim mendohet të jetë i ashtuquajtur *Raporti i Komisionit Hutchins*, "Një shtyp i lirë dhe i përgjegjshëm", i botuar në vitin 1947. Raporti është rezultat i një studimi të kryer nga një komision i përbërë nga shkencëtarë dhe gazetarë, të udhëhequr nga Robert M. Haçins, atëherë kryetar i Universitetit të Çikagos.

Raporti thekson rëndësinë e arsimit për edukim mediatik për të promovuar një shtyp të lirë dhe të përgjegjshëm në një shoqëri demokratike. Rekomandohet që edukimi mediatik të mësohet në shkolla ndërsa edukatorët të vënë në dukje dhe t'u transferojnë nxënësve aftësitë për të vlerësuar në mënyrë kritike lajmet dhe informacionin që marrin nga media.

Kjo është arsyeja pse *Raporti i Komisionit Hutchins* është një dokument i rëndësishëm në historinë e edukimit mediatik dhe shihet si vendimtar në zhvillimin e arsimit për edukim mediatik në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në mbarë botën.

Që atëherë, qëllimet dhe rëndësia e edukimit mediatik janë zgjeruar dhe nevoja për të përfshirë edukimin mediatik në arsim theksohet gjithnjë e më shumë.

2.1.

SHQYRTIMI I DOKUMENTEVE DHE REKOMANDIMEVE NDËRKOMBËTARE

Në pesëmbëdhjetë vitet e fundit, veçanërisht pas shqyrtimit të efekteve të internetit dhe mediave sociale në nivel individual dhe shoqëror, janë zhvilluar disa dokumente dhe rekomandime të rëndësishme në lidhje me edukimin mediatic në arsim në nivel botëror dhe në Bashkimin Evropian.

1. Deklarata e UNESCO-s për edukim mediatic (1982)

Në vitin 1982, 19 vende e nënshkruan dokumentin dhe përmbajtja e tij hapi rrugën për përfshirjen e edukimit mediatic në sistemet arsimore në shumë vende. Deklarata u bën thirrje institucioneve kompetente:

- të iniciojnë dhe mbështesin programe gjithëpërfshirëse të edukimit mediatic – nga niveli parashkollor në atë universitar, si dhe në kuadër të arsimit për të rritur, me qëllim zhvillimin e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve që do të nxisin rritjen e ndërgjegjësimit kritik dhe kompetencës më të madhe midis përdoruesve të mediave elektronike dhe të shtypura;
- të zhvillojnë trajnime për mësuesin dhe edukatorët me qëllim rritjen e njohurive dhe të kuptuarit e mediave dhe trajnimin e tyre për metodat përkatëse të mësimit;
- të stimulojnë aktivitetet kërkimore dhe zhvillimore në lidhje me edukimin mediatic brenda fushave si psikologjia, sociologjia dhe shkencat e komunikimit;
- të mbështesin dhe të forcojnë aktivitetet që synojnë nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar në edukimin mediatic.

2. Konferencat vjetore për edukim mediatic (1998 – 2022) të organizuara nga Asociacioni Kombëtar për arsim për edukim mediatic të SHBA-ve (NAMLE)

Në konferencat vjetore, edukatorët, politikëbërësit dhe profesionistët mediatic mbledhen për të diskutuar rëndësinë e edukimit mediatic në arsim. Nga konferencat dalin rekomandime për promovimin e arsimit për edukim mediatic që janë relevante për politikatat e arsimit në të gjithë botën. Disa nga rekomandimet kryesore nga konferencat dhe publikimet e NAMLE përfshijnë:

- integrimi i arsimit për edukim mediatic në shkolla/programe mësimore në të gjitha nivelet dhe në të gjitha fushat lëndore;
- ofrimin e mundësive për zhvillim profesional për mësuesin për të përmirësuar aftësitë e tyre për edukim mediatic dhe për të përfshirë edukimin mediatic në mësimit;
- nxitja e bashkëpunimit midis edukatorëve, profesionistëve të medias dhe studiuesve për të zhvilluar programe dhe burime efektive të edukimit mediatic;
- promovimi i mendimit kritik dhe analizës së mesazheve mediaticke dhe ndikimi i tyre në shoqëri;
- mbështetja e zhvillimit të kompetencave për edukim mediatic, duke përfshirë aftësinë për qasje, analizë, vlerësim dhe krijim në mesazhet mediaticke;
- njohja e rëndësisë së edukimit mediatic në promovimin e angazhimit qytetar dhe pjesëmarrjes në një shoqëri demokratike;
- inkurajimi i zhvillimit të programeve arsimore për edukimin mediatic që janë të rëndësishme nga pikëpamja kulturore dhe adresojnë çështje të drejtësisë sociale dhe barazisë.

Edhe pse këto rekomandime nuk adresojnë të gjitha çështjet dhe sfidat e edukimit mediatik në arsim, ato megjithatë përbëjnë bazën për politikë-bërësit dhe edukatorët e interesuar në zhvillimin dhe integrimin e edukimit mediatik në sistemet arsimore.

3. Raporti i Komisionit të Institutit Aspen mbi Nevojat për informim të komuniteteve në demokraci (2009)

Raporti thekson nevojën për arsimim për edukim mediatik në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Komisioni kërkon që edukimi mediatik të përfshihet në programet mësimore në të gjitha nivelet e arsimit dhe të shihet si kompetencë thelbësore për pjesëmarrjen qytetare.

Këto dokumente theksojnë nevojën për arsimim për edukim mediatik në epokën e sotme digjitale dhe ofrojnë udhëzime për mësimdhënësit dhe politikë-bërësit se si të promovojnë edukimin mediatik në shkolla dhe komunitete.

4. Programi i UNESCO-s për edukim mediatik dhe informativ (MIL) për mësimdhënësit (2011)

Ky dokument ofron udhëzime për edukatorët se si t'i mësojnë nxënësit për edukimin mediatik dhe informativ. Është miratuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (UNESCO) në vitin 2011 dhe përfshin një sërë kompetencash që duhet të zhvillojnë nxënësit për t'u bërë qytetarë të informuar dhe të përgjegjshëm në një botë digjitale. Kompetencat kryesore që i paraqet në dokumenti janë:

- të kuptuarit e rolit të mediave dhe informacioneve në shoqëri (të kuptuarit e llojeve të ndryshme të mediave dhe rolin e tyre në formimin e opinionit publik dhe ndikimin në vendimmarrje);

- qasja dhe vlerësimi i mediave dhe informacionit (zhvillimi i aftësive për të gjetur, vlerësuar dhe përdorur në mënyrë efektive lloje të ndryshme të mediave dhe burimeve të informacionit);
- krijimi i mediave dhe informacionit (krijimi dhe ndarja e llojeve të ndryshme të mediave dhe informacionit, duke përfshirë tekstin, imazhet dhe videon);
- të kuptuarit e etikës së medias dhe informacionit (të kuptuarit e konsideratave etike të përfshira në krijimin dhe shkëmbimin e mediave dhe informacioneve, duke përfshirë çështje si privatësia, e drejta e autorit dhe plagjiatura);
- të kuptuarit e ligjit për median dhe informacionin (të kuptuarit e kuadrit ligjor rreth medias dhe informacionit, duke përfshirë çështje si liria e fjalës, shpifja dhe censura);
- të kuptuarit e arsimit për edukim mediatik dhe informativ (të kuptuarit e parimeve dhe praktikave të arsimit për edukim mediatik dhe informativ, duke përfshirë zhvillimin e programeve mësimore, metodat e mësimdhënies dhe vlerësimin).

Këto kompetenca janë krijuar për të ndihmuar mësimdhënësit të zhvillojnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e nevojshme për t'i mësuar në mënyrë efektive nxënësit e tyre rreth edukimit mediatik dhe edukimit informativ.

5. Aleanca Globale për Partneritete për edukim mediatik dhe edukim Informativ (GAPMIL) (2013)

Aleanca u promovua nga UNESCO në vitin 2013 dhe u mbështet nga një numër organizatash partnere, duke përfshirë Aleancën e Qytetërimeve të Kombeve të Bashkuara (UNAOC) dhe Rrjetin për Edukim Mediatik dhe Informativ dhe Dialog Ndërkulturor (MILID). Kjo organizatë bashkon individë dhe institucione nga e gjithë

bota për të promovuar arsimin për edukim mediatik dhe edukim informativ.

GAPMIL ka zhvilluar parime dhe udhëzime për arsimin për edukim mediatik dhe edukim informativ, të cilat shërbejnë si udhëzues për politikë-bërësit dhe edukatorët dhe përfshijnë:

- të drejtën për të pasur qasje në informacion dhe për të shprehur pikëpamje të ndryshme;
- promovimin e lirisë së shprehjes dhe pluralizmit mediatik;
- nevojën për të zhvilluar të menduarit kritik dhe aftësitë analitike për vlerësimin e mesazheve mediatike;
- promovimin e krijmtarisë dhe aftësisë për të krijuar përmbajtje mediatike;
- njohjen e rolit mediatik dhe informativ në promovimin e përfshirjes sociale, diversitetit kulturor dhe pjesëmarrjes demokratike;
- rëndësinë e bashkëpunimit midis aktorëve të ndryshëm në promovimin e arsimit për edukim mediatik, përfshirë edukatorët, profesionistët mediatik dhe organizatat e shoqërisë civile;
- nevojën për të promovuar edukimin mediatik në arsim gjatë gjithë jetës, nga fëmijëria e hershme deri në moshën e rritur;
- nevojën për të promovuar edukimin mediatik në arsim si në mjediset arsimore formale ashtu edhe joformale.

GAPMIL ka zhvilluar edhe udhëzime për sistemet arsimore për edukim mediatik që përfshijnë rekomandime për zhvillimin e programeve mësimore, trajnimin dhe vlerësimin e mësimdhënësve. Qëllimi i këtyre udhëzimeve është të ofrojë udhëzime praktike për edukatorët dhe politikë-bërësit që dëshirojnë të promovojnë arsimin e edukimit mediatik në komunitetet e tyre.

6. Rekomandimi i Këshillit të Evropës për edukim mediatik në mjedisin digjital (2018)

Ky dokument ofron udhëzime për promovimin e edukimit mediatik në Evropë dhe inkurajon Shtetet Anëtare të zhvillojnë strategji gjithëpërfshirëse të arsimit për edukim mediatik. Ky dokument u miratua nga Këshilli i Evropës në vitin 2018 dhe thekson rëndësinë e edukimit mediatik në promovimin e qytetarisë demokratike, mendimit kritik dhe përfshirjes sociale.

Në vitin 2023, Komisioni Evropian shtoi udhëzime se si shtetet anëtare duhet të raportojnë mbi përparimin në nxitjen dhe zhvillimin e aftësive të edukimit mediatik me miratimin e legjislacionit dhe akte nënligjore, me sigurimin e mbështetjes institucionale, financim, zhvillimin e programeve mësimore dhe vlerësimin e veprimeve të ndërmarra.

7. Rezoluta e Parlamentit Evropian për luftën kundër dezinformatave (2018)

Në vitin 2018, Parlamenti Evropian miratoi një rezolutë që thekson nevojën për arsim për edukim mediatik për luftë kundër dezinformatave dhe lajmeve të rreme. Rezoluta i bën thirrje Komisionit Evropian dhe vendeve anëtare të zhvillojnë strategji për edukim mediatik dhe të rrisin fondet për programet për edukim mediatik.

8. Java Evropiane për edukim mediatik e Komisionit Evropian (2019)

Komisioni Evropian filloi Javën Evropiane të Edukimit Mediatik në vitin 2019, me qëllim të rritjes së ndërgjegjësimit për rëndësinë e edukimit mediatik tek qytetarët evropianë. Iniciativa përfshin ngjarje, punëtori dhe online burime për promovimin e arsimit për edukim mediatik.

9. Udhëzime për mësime dhe edukatorët për përbalje me dezinformata dhe për promovim të edukimit digjital përmes arsimit dhe trajnimit (2021)

Në vitin 2021, Komisioni Evropian publikoi *Udhëzime për mësime dhe edukatorët për përbalje me dezinformata dhe për promovim të edukimit digjital përmes arsimit dhe trajnimit*¹¹, të cilat përfaqësojnë një angazhim të qartë për forcimin e rolit të arsimit dhe trajnimit në promovimin e edukimit digjital dhe përbaljes me dezinformata. Dokumenti thekson rolin qendror të mësimeve dhe edukatorëve në arsimin fillor dhe të mesëm për të ndihmuar të rinjtë të fitojnë kompetenca dhe aftësi të të mësuarit gjatë gjithë jetës në mjedisin e ri digjital. Duke njohur trendin se teknologjitë digjitale do të ndikojnë në të gjitha fushat e jetës, profesionale dhe private, *Udhëzimet* theksojnë se zotërimi i aftësive dhe njohurive digjitale në klasë do t'i ndihmojë të rinjtë të bëhen qytetarë aktivë të shekullit 21. Dokumenti përmban objektiva mësimore, praktika pedagogjike dhe aktivitete praktike për të frymëzuar dhe ndihmuar mësime dhe edukatorët të inkorporojnë këto tema dhe aftësi të rëndësishme dhe t'i zbatojnë ato në klasë. Temat kanë të bëjnë me ndërtimin e aftësive për edukim digjital në klasë dhe në shkollë, çfarë janë dezinformata dhe udhëzime praktike për mësime për të vlerësuar edukimin digjital në klasë.

11 Komisioni Evropian (2021). *Udhëzime për mësime dhe edukatorët për përbalje me dezinformata dhe promovimin e edukimit digjital përmes arsimit dhe trajnimeve*. [udhëzime për mësuesit dhe edukatorët për trajtimin e NC0922371ENN (2).pdf].

10. Udhëzime etike për edukatorët për përdorimin e inteligjencës artificiale dhe të dhënave gjatë mësimeve dhe mësimit (2022)

Duke marrë parasysh përdorimin në rritje të inteligjencës artificiale (IA) në sfera të ndryshme, Komisioni Evropian ka miratuar gjithashtu *Udhëzime Etike për edukatorët për përdorimin e inteligjencës artificiale dhe të dhënave gjatë mësimeve dhe mësimit*.¹² Qëllimi është të ndihmojë mësime dhe edukatorët të mendojnë se si mund të përdorin inteligjencën artificiale dhe të dhënat në praktikën e tyre të përditshme, përkatësisht në shkollat në mbarë Evropën. Dokumenti thekson se përdorimi i sistemeve të IA-së mund të përmirësojë potencialisht mësime dhe të nxënësve, të sigurojë rezultate më të mira të të nxënësve dhe të ndihmojë shkollat të funksionojnë në mënyrë më efektive. Sidoqoftë, nëse ato aplikacione për IA nuk janë dizajnuar ose përdorur siç duhet ose pa kujdes, arsimi mund të vuajë pasoja të dëmshme. Prandaj, këto udhëzime duhet tu ndihmojnë edukatorëve të jenë të kujdesshëm dhe të sigurt se përdorimi i IA-së është i sigurt, i drejtë, dhe se po përdoret për qëllime të mira.

11. Standardet e nxënësve të Shoqatës Ndërkombëtare për Teknologji në Arsim në SHBA (ISTE) (2016)

Këto standarde përqendrohen në qytetarinë digjitale, e cila përfshin aftësitë e edukimit mediatic, të tilla si të kuptuarit e ndikimit të mesazheve mediatike, vlerësimi i besueshmërisë së burimeve dhe përdorimi i medias për komunikim në mënyrë efektive. Ato janë pranuar nga shumë institucione të rëndësishme arsimore në të gjithë botën, duke

12 Komisioni Evropian (2022). *Udhëzime etike për edukatorët për përdorimin e inteligjencës artificiale dhe të dhënave gjatë mësimeve dhe mësimit*. [ethical guidelines on the use of artificial intelligence-NC0722649ENN.pdf].

përfshirë: Ministrinë e Arsimit të Shteteve të Bashkuara, Shoqatën Kombëtare të Arsimit (AKE), Shoqatën Amerikane të Bibliotekarëve të Shkollave (AASL), Organizatën Ndërkombëtare të Baccalaureate, Rrjetin Evropian të Shkollave dhe Shoqatën Ndërkombëtare për Arsim (ISTE). Përveç këtyre organizatave, shumë shkolla individuale kanë miratuar edhe këto standarde si një kornizë për integrimin e teknologjisë dhe mediave digjitale në praktikën e tyre mësimore dhe promovimin e qytetarisë digjitale dhe edukimit teknologjik të nxënësit.

2.2. PËRFAQËSIMI I EDUKIMIT MEDIATIK NË SISTEMET ARSIMORE TË VENDEVE TË TJERA

Edukimi mediatic është studiuar në mënyra të ndryshme dhe në shkallë të ndryshme në sistemet arsimore në mbarë botën për pesëdhjetë vjet. Mund të sugjerohet një përmbledhje e shkurtër se si paraqitet edukimi mediatic në disa vende të botës:

- Në Kanada, edukimi mediatic përfshihet si pjesë e programeve mësimore në shumicën e provincave dhe territoreve. Në disa shkolla, edukimi mediatic studiohet si lëndë e veçantë, dhe gjithashtu është i integruar në lëndë të ndryshme, siç janë gjuha angleze, shkencat sociale dhe edukimi shëndetësor.
- Në Australi, edukimi mediatic përfshihet në programet mësimore si një kompetencë e përgjithshme, që do të thotë se studiohet në të gjitha lëndët, duke theksuar zhvillimin e aftësive të mendimit kritik, komunikimit dhe krijimtarisë në lidhje me mediat dhe teknologjitë digjitale.
- Edukimi mediatic përfshihet në programet mësimore në Angli, Uells, Skoci dhe Irlandën

e Veriut, por mësohet ndryshe në secilin vend. Në Angli është e integruar në programin mësimor për gjuhë angleze, ndërsa në Skoci është lëndë më vete. Në Uells dhe Irlandën e Veriut, edukimi mediatic është i integruar në lëndë të ndryshme si gjuhë angleze dhe informatikë.

- Edukimi mediatic është i integruar në programin mësimor finlandez në fushën e lëndës Kompetenca digjitale, e cila përfshin tema të edukimi mediatic, kodimit/programimit dhe sigurisë në internet. Mësimdhënësit inkurajohen të përfshijnë edukimin mediatic në mësimdhënie në lëndë të ndryshme.
- Edukimi mediatic studiohet si lëndë e veçantë në programin mësimor të Koresë së Jugut, me fokus në kuptimin e mesazheve mediatike, prodhimin mediatic dhe etikën mediatike. Ai është gjithashtu i integruar në lëndë të tjera, të tilla si gjuha koreane dhe shkencat shoqërore.

Edukimi mediatic përfshihet në sistemet arsimore të vendeve të Bashkimit Evropian (BE), ku mund të hasen modele të ndryshme:

- Në Francë, edukimi mediatic është i integruar në programin mësimor brenda fushës së lëndës Informacione dhe Komunikim, e cila përfshin tema si qytetaria digjitale, analiza dhe prodhimi mediatic. Ajo është e përfshirë edhe në lëndë të tjera në fushën e historisë dhe gjeografisë.
- Në Gjermani, edukimi mediatic është i integruar në kurrikulën brenda fushës së lëndës Edukimi mediatic, i cili përfshin tema si historia e mediave, analiza e medias dhe prodhimi mediatic. Gjithashtu është i integruar në lëndë të tjera si gjuhë, arte dhe shkencat shoqërore.
- Në Itali, edukimi mediatic është i integruar në kurrikul si "Edukimi digjital" dhe përfshin tema si: qytetaria digjitale, analiza e medias dhe prodhimi mediatic. Gjithashtu është

e përfshirë në lëndë të tjera të tilla si gjuhë, arte dhe shkenca shoqërore.

- Në Spanjë, edukimi mediatic është i integruar në kurrikul si fushë e “Komunikimit dhe Reklamimit Audioviziv”, e cila përfshin tema si analiza e mediave, produksioni mediatic dhe etika mediatike. Gjithashtu është e integruar edhe në lëndë të tjera.
- Në Holandë, edukimi mediatic përfshihet si një objektiv specifik i të mësuarit në arsimin fillor dhe të mesëm. Ai është i integruar në lëndë të ndryshme si gjuhë, art, shkenca sociale dhe teknologji digjitale.
- Në arsimin fillor të Sllovenisë, edukimi mediatic është i integruar në lëndë të ndryshme në fushën e gjuhës dhe letërsisë slovene, shkencave shoqërore dhe informatikës. Nxënësit mësojnë rreth formave të ndryshme të medias, të tilla si media e shkruar, digjitale, audiovizive dhe online, si dhe eksplorojnë tema në fushën e përfaqësimit mediatic, reklamimit, propagandës dhe verifikimit të informacionit.

Nga shembujt e dhënë, mund të konkludohet se edukimi mediatic kryesisht studiohet si lëndë e veçantë ose integrohet në lëndë të tjera siç janë gjuhë, art, shkenca sociale dhe teknologji digjitale. Ajo është e përfshirë në fusha të ndryshme lëndore dhe objektiva të të nxënësve në vendet e BE-së, me fokus në zhvillimin e mendimit kritik, qytetarisë digjitale dhe aftësive për prodhim mediatic. Zbatimi specifik i arsimit për edukim mediatic ndryshon në varësi të karakteristikave të sistemit arsimor të secilit vend veç e veç.

2.3. EDUKIMI MEDIATIK NË SISTEMIN ARSIMOR NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Edukimi mediatic, në dekadën e fundit, është përfshirë në arsimin fillor dhe të mesëm në të gjitha nivelet në vendin tonë në mënyra të ndryshme, duke filluar nga aktivitetet joformale të projekteve të OJQ-ve, hulumtime, zbatim të trajnimeve të mësimdhënësve dhe realizim të aktiviteteve në shkolla si pjesë e projekteve të organizatave të mbështetura nga institucionet e sistemit, deri te përfshirja e edukimit mediatic në mënyra të ndryshme në dokumentet profesionale dhe rregullatore.

Projektet dhe aktivitetet e realizuara për edukim mediatic:

- Një nga iniciativat e para për promovimin dhe përfshirjen e edukimit mediatic në arsimin në Maqedoninë e Veriut u zbatua në kuadër të projektit “Promovimi i edukimit mediatic në arsim në Maqedoni” (2009 – 2011) i zbatuar nga Instituti Maqedonas për Media, Instituti për Demokraci, Qendra Evropiane për Gazetari nga Mاستrihti, Holandë, në bashkëpunim me Byronë për Zhvillimin e Arsimit. Në kuadër të projektit, u zhvilluan trajnime për rreth 1.100 mësimdhënës nga shkollat fillore dhe të mesme, të cilët u trajnuan për edukim mediatic në mësimdhënie. Në vitin 2010, u publikua Doracak për mësimin e edukimit mediatic në lëndën e gjuhës amtare (maqedonisht, shqip, serbisht dhe turqisht), që synonte të ndihmonte mësimdhënësit të avancuarin njohuritë e nxënësve për rolin dhe funksionin e medias në shoqëritë demokratike. Instituti Maqedonas për Media ka kryer aktivitete të ndryshme në lidhje me edukimin mediatic që nga viti 2009, si

trajnime, konferenca, fushata, hulumtime dhe krijimin e burimeve për promovim të ndërgjegjësimit dhe njohuritë e grupeve të ndryshme të synuara për këtë temë. Instituti bashkëpunon me institucione, organizata të shoqërisë civile, media dhe gazetarë, shkolla, staf mësimdhënës dhe me nxënës për të inkurajuar përfshirjen sistematike të edukimit mediatic, kryesisht në sferat arsimore dhe mediatiche.

- Projekti i USAID-it për edukim mediatic “Të rinjtë mendojnë” (2021 – 2026) është projekti më i madh deri më tani në fushën e edukimit mediatic në Maqedoninë e Veriut. Fokusi i aktiviteteve është përfshirja e edukimit mediatic në programet mësimore në arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë. Projekti gjithashtu organizon trajnime për mësimdhënësit nga shkollat fillore dhe të mesme për edukimin mediatic, ofron burime dhe materiale për përgatitjen e orës, duke përfshirë manuale për mësimdhënësit për realizimin e mësimdhënies. Qëllimi i projektit është të ndërtojë rezistencë kundër dezinformimit, si dhe të krijojë një qytetari aktive, të nxitur nga empatia dhe të përgjegjshme. “Të rinjtë mendojnë” është një projekt i USAID-it i zbatuar nga IREX në partneritet me Institutin Maqedonas për Media (IMM), Institutin për Studime të Komunikimit (ISK) dhe Forumin Arsimor Rinor (FAR), dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës (MASH), Byronë për Zhvillimin e Arsimit (BZHA) dhe Qendrën Shtetërore të Provimeve (QSHP).
- Instituti për Studime të Komunikimit (ISK) promovon edukimin mediatic midis qytetarëve në bashkëpunim me mediat, organizatat e shoqërisë civile, institucionet akademike dhe publike. Instituti zhvillon kurse arsimore dhe prodhon burime që mund të përdoren në mësimdhënie dhe online, si dhe organizon aktivitete dhe ngjarje vjetore, si fushata ndërgjegjësimi, kampe për edukim

mediatic për nxënësit e shkollave të mesme dhe Dita e Edukimit Mediatic, në kuadër të së cilës organizohen kuize online, takime tematike joformale midis profesionistëve digjitalë, uebinarë, vizita për njohjen e mediave.

Platforma online “Medium” (www.medium.edu.mk) është një iniciativë kryesore rinore e ISK-së, që ka filluar në vitin 2011, përmes së cilës të rinjtë mund të shprehin lirshëm për çështje që ndikojnë në jetën e tyre. “Medium” bazohet në partneritete joformale me pothuajse 40 shkolla të mesme dhe afërsisht 30 media. Informacion mbi aktivitetet e shumta që lidhen me edukimin mediatic në shkollat e mesme mund të gjenden në faqen e internetit.

- Në kuadër të projektit “Mendimi kritik për qytetarët me shkathtësi mediatiche – KriThink”, i zbatuar nga Fondacioni Metamorfozis dhe EUROTHINK, dhe i financuar nga Bashkimi Evropian në periudhën 2018 – 2020, u krye një hulumtim me qëllim të analizimit të situatës në fushën e afiniteteve dhe qëndrimeve që grupi i synuar (të rinjtë) kanë ndaj procesit të të menduarit kritik. Përveç këtij aspekti, hulumtimi përqendrohet në shprehitë për informim, përdorimin e mediave dhe format e ndryshme të mjeteve të informacionit midis të rinjve në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Përndryshe, objektivi i përgjithshëm i projektit është promovimi i edukimit mediatic si bazë për ruajtjen e së drejtës së qytetarëve për të pasur mendime të ndryshme, duke stimuluar një kulturë të mendimit kritik, pluralizmit të mendimeve dhe vlerave demokratike.
- Fondacioni Metamorfozis, me mbështetjen e Fondacionit Shoqëri e Hapur – Maqedoni, në periudhën 2019 – 2022, realizoi disa aktivitete mësimore, konferenca dhe aktivitete të tjera kushtuar edukimit mediatic dhe aktualizimit të nevojës për arsimim për edukim mediatic.

- Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, në pajtim me kompetencat e saj ligjore, ndërmerr aktivitete të ndryshme për zhvillimin e edukimit mediatik. Agjencia organizon trajnime të grupeve të ndryshme të synuara për edukim mediatik, bashkëpunon me organizatat qeveritare dhe joqeveritare dhe mbështet aktivitetet që synojnë promovimin dhe zhvillimin e edukimit mediatik.
- Një nga iniciativat më domethënëse për mbështetjen, promovimin dhe avancimin e edukimit mediatik është krijimi i Rrjetit për edukim mediatik, i menaxhuar nga Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, me qëllim të lehtësimit të komunikimit dhe konsultimit midis subjekteve të ndryshme në vend, që punojnë në ngritjen e nivelit të edukimit mediatik të të gjithë qytetarëve. Në vitin 2023, RrEM numëronte 83 anëtarë – institucione publike dhe ministri, organizata të shoqërisë civile, institucione arsimore, media, kompani dhe individë. Që nga viti 2019, Rrjeti gjithashtu organizon Ditët e Edukimit Mediatik, një ngjarje globale vjetore e iniciuar nga UNESCO, në kuadër të së cilës organizohen ngjarje të ndryshme që lidhen me aspektet e edukimit mediatik në arsim, industrinë e medias dhe sferat e tjera sociale. Kështu, për shembull, ngjarja “Mësimdhënësit kryesorë për ngritjen e vetëdijes për edukim mediatik” e organizuar nga Instituti Maqedonas për Media (IMM) iu kushtua ndikimit të mediave sociale tek të rinjtë, përdorimit të teknologjive të reja për të fituar njohuri dhe aftësi, si dhe të ardhmes së edukimit mediatik në arsim.

2.4. HULUMTIME DHE REKOMANDIME PËR EDUKIMIN MEDIATIK

Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale në bashkëpunim me OSBE-në zhvilloi dy sondazhe mbi nivelet e edukimit mediatik në mesin e popullsisë (+16) në vitin 2016 dhe 2019, të cilat janë tregues fillestar të niveleve të edukimit mediatik në Maqedoninë e Veriut.¹³ Hulumtimi i vitit 2019 sugjeron që gjeneratat e reja kanë më shumë aftësi dhe shkathtësi digjitale sesa grupet e vjetra në shoqëri, por atyre u mungojnë aftësitë që lidhen me shkrim-leximin funksional, përkatësisht për të përdorur në mënyrë aktive dhe efektive teknologjitë e komunikimit dhe mediat në mjedisin modern digjital. Kështu, për shembull, theksohet se audiencia është pak aktive në krijimin e përmbajtjeve dhe informacioneve personale, dhe arsyet për këtë lidhen jo vetëm me mungesën e aftësive dhe shkathtësive në mesin e popullatës, por edhe me faktorët që përcaktojnë mjedisin më të gjerë socio-politik, arsimor dhe kulturor. Disa nga rekomandimet kryesore të hulumtimit janë:

- zhvillimi i integruar i kompetencave digjitale dhe mediatike, të menduarit kritik dhe njohurive dhe ndërgjegjësimit qytetar në të gjithë sistemin arsimor formal dhe joformal. Kështu, duhet të promovohet ndërgjegjësimi për përgjegjësinë qytetare dhe ndërgjegjësimi kritik në përdorimin, krijimin dhe shkëmbimin e informacionit në sferën publike;
- zhvillimi i programeve për mësim gjatë gjithë jetës në fushën e edukimit digjital dhe mediatik që synojnë grupet e vjetra ose

¹³ ASHMAA (2016). *Anketë për edukim mediatik te popullsia e rritur në Maqedoni*. [<https://mediumskapismenost.mk/avmu-istrazuvanje-za-mp-kaj-vozasnata-populacija-narm/>]; ASHMAA (2019). *Anketë për nivelin e EM në popullsinë 16+*. [<https://mediumskapismenost.mk/kampanja-dvapati-proveri-ednash-veruvaj/>]

segmente të tjera të popullsisë, me qëllim zvogëlimin e “hendekut digjital” që rezulton nga dallimet në njohuri, qasje ose faktorë të tjerë;

- mediat, veçanërisht shërbimi publik, me aktivitetet dhe projektet e tyre, të kontribuojnë në ngritjen e kompetencave të mediave të qytetarëve dhe në zhvillimin e aspekteve pjesëmarrëse - komunikuese të edukimit mediatic.

Shkolla lartë e Gazetarisë dhe Instituti i Studimeve të Komunikimit kanë kryer dy sondazhe që adresojnë përfaqësimin e edukimit mediatic në arsimin formal. Anketa e vitit 2016 “Edukimi mediatic në Maqedoni: një mjet i humbur për qytetari aktive” trajton përfaqësimin e edukimit mediatic në arsimin e mesëm, në sektorin civil dhe në mesin e mediave.

Në vitin 2018, u krye sondazhi “Edukimi mediatic në Maqedoni – një përpjekje për të zbatuar në arsimin fillor”¹⁴ me qëllim të përcaktimit të situatës aktuale në zbatimin e edukimit mediatic në arsimin fillor në Maqedoninë e Veriut. Pyetjet kryesore të ngritura në këtë hulumtim janë: si trajtohet edukimi mediatic në arsim, cilat aftësi fitojnë nxënësit në fushën e edukimit mediatic, cilat forma të marrjes së njohurive në lidhje me edukimin mediatic përdoren (materiali didaktik, pajisjet, kushtet hapësinore, aktivitetet shkollore dhe jashtëshkollore) dhe cili është edukimi i stafit mësimor në lidhje me edukimin mediatic.

Rekomandimet e hulumtimit janë si më poshtë:

- prezantimi i konceptit të edukimit mediatic në procesin arsimor si një model ndër-kurrikular i edukimit mediatic. Hartimi, planifikimi dhe zbatimi i një programi të edukimit mediatic në arsimin fillor, objektivat

e të cilit do të jenë komplementare me tre elementet themelore të këtij koncepti: qasja, analiza dhe prodhimi i përmbajtjes mediatike në të gjitha format e mundshme;

- rishikimi i planeve mësimore dhe programeve ekzistuese në arsimin fillor duke përfshirë tema që synojnë nxitjen e perceptimit dhe analizës kritike të përmbajtjes mediatike, veçanërisht ato ndaj të cilave nxënësit janë më të ekspozuar – mediat e reja dhe rrjetet sociale. Fuqizimi i nxënësve me aftësi dhe njohuri për prodhuesin mediatic dhe përdorimi i avantazheve të mediave për të artikuluar interesat e tyre si qytetarë aktivë në shoqëri;
- hartimin e një politike për trajnimin e vazhdueshëm, programet e zhvillimit profesional dhe edukimin e stafit mësimor për edukim mediatic. Zhvillimi i një sistemi për vlerësimin e angazhimit të mësimit nënësve në aktivitete që inkurajojnë edukimin mediatic midis nxënësve (menaxhimi i gazetarisë, dramës dhe seksioneve të ngjashme, përgatitja dhe mirëmbajtja e një gazete shkollore – të shtypur ose online, organizimi i aktiviteteve dramaturgjike dhe teatrore, etj.);
- modernizimi i literaturës së përdorur në mësimit nënësve me tema për edukim mediatic: rishikimi i teksteve shkollore – në të gjitha gjuhët në të cilat zhvillohet mësimi – në të cilat trajtohet roli i mediave në jetën moderne dhe pasurimi i mjeteve didaktike për mësimit nënësve në këtë fushë (manuale, praktika, etj.);
- përfshirje më e madhe e Byrosë për Zhvillimin e Arsimit në monitorimin e zbatimit të programeve mësimore, me qëllim përcaktimin në kohë të nevojave të stafit mësimor dhe nxënësve, veçanërisht në temat që synojnë nxitjen e arsimit mediatic tek nxënësit.

¹⁴ Shopar, V., Temenugova, A. dhe Aksentievskaja, M. (2018). *Edukimi mediatic në Maqedoni: Përpjekje për implementim në arsimin fillor*. Shkolla e Gazetarisë dhe Marrëdhëniet me Publikun. [<http://www.medium.edu.mk/attach/Mediumskata-pismenost-vo-Makedonija-obid-za-impelementacija-vo-osnovoto-obrazovanie-MKD.pdf>].

3

KOMPETENCAT PËR EDUKIM MEDIATIK NË STANDARDET KOMBËTARE PËR ARSIMIN FILLOR

3.1. STANDARDET KOMBËTARE NË ARSIMIN FILLOR

Së bashku me *Konceptin 2020 për arsimin fillor* janë miratuar *Standardet Kombëtare për arritjet e nxënësve në fund të arsimit fillor*. Standardet Kombëtare përfshijnë kompetencat kryesore për mësim gjatë gjithë jetës, të cilat rrjedhin nga Rekomandimi i Këshillit të BE-së të vitit 2018 dhe gjithashtu marrin parasysh rekomandimet nga studimet ndërkombëtare dhe dokumentet e tjera të BE-së të dizajnuara për të përmirësuar cilësinë e arsimit në vendet anëtare dhe për të harmonizuar sistemet e arsimit në Evropë.

Kompetencat paraqesin një kombinim të njohurive, aftësive dhe qëndrimeve, ku:

- *njohuri* do të thotë fakte, procedura, koncepte, ide dhe teori, të cilat mbështesin të kuptuarit e një fushe ose subjekti të caktuar;
- *aftësi* konsiderohen edhe kapacitetet për zbatimin e njohurive të fituara;
- *qëndrimet*, përkatësisht vlerat, përfshijnë mendimet, besimet dhe gatishmërinë për të vepruar ose reaguuar ndaj ideve, personaliteteve ose situatave.

Kompetencat kryesore për mësim gjatë gjithë jetës nga korniza evropiane përshtaten si me moshën

e nxënësve që përfundojnë arsimin fillor ashtu edhe me kontekstin e shoqërisë maqedonase, dhe përkufizimi i tyre gjithashtu merr parasysh përvojat në arsimin fillor në vendin tonë. Pas përshtatjes, tetë fushat e kompetencës për të mësuarit gjatë gjithë jetës të kornizës evropiane përcaktohen si:

- I. EDUKIM GJUHËSOR
- II. PËRDORIMI I GJUHËVE TË TJERA
- III. MATEMATIKA DHE SHKENCAT NATYRORE
- IV. EDUKIM DIGJITAL
- V. ZHVILLIMI PERSONAL DHE SOCIAL
- VI. SHOQËRIA DHE KULTURA DEMOKRATIKE
- VII. TEKNIKA, TEKNOLOGJIA DHE SIPËRMARRJA
- VIII. SHPREHJA ARTISTIKE DHE KULTURA.

Duke zhvilluar edukimin mediatik, nxënësit e shkollave fillore fuqizohen:

- të mendojnë në mënyrë kritike (të zbulojnë kuptimin e mesazheve dhe të krijojnë mesazhe përmes të cilave ata mund të shprehin mendimin e tyre);
- të përdorin informacionet me mençuri (të përcaktojnë besueshmërinë e informacionit dhe të zbulojnë qëllimin dhe teknikat në reklamim);
- të njohin një këndvështrim të shprehur (të vlerësojnë këndvështrime të ndryshme dhe të përdorin informacionin për të krijuar dhe/ose modifikuar këndvështrimin e tyre);
- të krijojnë me përgjegjësi përmbajtje (të përcjellin mesazhet që duan të thonë, të vetëdijshëm për pasojat e kësaj);
- të njohin rolin e medias në kulturën e tyre (të njohin ndikimin e mesazheve të përcjella përmes mediave mbi të menduarit dhe veprimet e njerëzve);
- të kuptojnë qëllimin e mesazheve (të kuptojnë se çfarë dëshiron të arrijë autori kur krijon dhe përcjell një mesazh të veçantë).¹⁵

¹⁵ Common sense media (2020). *What is media literacy and why is it important?* [https://www.common sense media.org/articles/what-is-media-literacy-and-why-is-it-important].

Kompetencat e listuara në fushën e edukimit mediatik janë të ngulitura në disa fusha të Standardeve Kombëtare, kryesisht si komponentë të kompetencave transversale që pritet të fitohen përmes shumicës së lëndëve të detyrueshme. Shumica e kompetencave që lidhen me edukimin mediatik mund të njihen në fushën e edukimit digjital (IV). Këtu bëjnë pjesë njohuritë dhe aftësitë e mëposhtme, si dhe qëndrimet/vlerat:

Nxënësi/nxënësja di dhe/ose mund:

- » të hulumtojë dhe krahasojë mundësitë e pajisjeve digjitale të njohura dhe të reja dhe të vlerësojë, përzgjedhë dhe përdorë në mënyrë të pavarur ato që janë më të përshtatshme për një nevojë dhe situatë specifike;
- » të përdorë mënyra të ndryshme të organizimit dhe ruajtjes dhe ndarjes së sigurt të përmbajtjes në pajisje dhe rrjete të ndryshme në mjedisin digjital;
- » të përcaktojë se çfarë informacione i nevojiten, të gjejë, përzgjedhë dhe shkarkojë të dhëna, informacione dhe përmbajtje digjitale dhe të vlerësojë rëndësinë e tyre në lidhje me nevojën specifike dhe besueshmërinë e burimit;
- » të zgjedhë dhe të përdorë mjete të ndryshme për përpunimin e të dhënave, të analizojë të dhënat dhe t'i prezantojë ato në mënyra të ndryshme duke respektuar rregullat e përdorimit;
- » të zgjedhë dhe përdorë mjetet e përshtatshme të TIK-ut për komunikim, shkëmbimin e sigurt të informacioneve, të kontaktojë dhe bashkëpunojë me të tjerët në projekte online, në aktivitete sociale ose për nevoja personale;
- » në mënyrë të sigurt dhe të përgjegjshme të përdorë përmbajtjen digjitale, rrjetet arsimore dhe sociale dhe retë digjitale;
- » në komunikimin me të tjerët në hapësirën digjitale multikulturore, respekton pjesëmarrësit e ndryshëm dhe ndjek normat ligjore, kulturore dhe etike të sjelljes në hapësirën digjitale;

- » të kujdeset për identitetin personal digjital, sigurinë dhe reputacionin dhe të respektojë politikat e privatësisë;
- » të eksplorojnë mundësitë për përdorimin e modeleve dhe simulimeve të ndryshme, duke kombinuar paraqitje statike dhe dinamike, tinguj, tekst dhe imazhe për të modifikuar ose krijuar produkte të thjeshta multimediale krijuese për një qëllim të caktuar dhe për një audiencë specifike;
- » të përcaktojnë kriteret e cilësisë për produktet dhe zgjidhjet digjitale, duke përfshirë inovacionin dhe dobinë.

Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:

- » përdorimi i papërgjegjshëm dhe jo i duhur i TIK-ut ka pasoja dhe mund të sjellë rreziqe për individin ose shoqërinë;
- » potencialet e TIK-ut do të rriten dhe duhet të monitorohen dhe përdoren, por gjithashtu duhet të ketë një qëndrim kritik ndaj besueshmërisë, konfidencialitetit dhe ndikimit të të dhënave dhe informacionit të disponueshëm përmes pajisjeve digjitale;
- » në hapësirën digjitale është e rëndësishme të sigurohet mbrojtja e identitetit, privatësisë dhe sigurisë emocionale, të mos përdoret gjuha e urrejtjes dhe dhuna kibernetike dhe të respektohen rregullat dhe normat e komunikimit në komunitetet digjitale;
- » informacionet e disponueshme në hapësirën digjitale duhet të përdoret në mënyrë etike, sipas rregullave të përcaktuara dhe për të mirën e njerëzve.

Prania e kompetencave në lidhje me edukimin mediatic është gjithashtu e rëndësishme në fushat: shkrim lexim gjuhësor (II), zhvillimi personal dhe social (V) dhe shoqëria dhe kultura demokratike (VI). Në këto fusha, njohuritë dhe aftësitë e mëposhtme janë më të rëndësishme:

Nxënësi/nxënësja di dhe/ose mund:

- » të shprehë dhe të përcjellë mendimet, ndjenjat, informacionet dhe qëndrimet e tij/ saj në situata të ndryshme komunikimi

në gjuhën e amtare, përmes mjeteve të ndryshme dhe për qëllime të ndryshme;

- » të përdorë informacione nga burime dhe media të ndryshme dhe t'iu qaset atyre në mënyrë kritike, duke marrë parasysh burimin, kontekstin, qëllimin dhe besueshmërinë e informacionit të paraqitur;
- » të analizojë në mënyrë kritike informacionin dhe provat sipas kriterëve përkatëse;
- » të shpjegojë se si faktorët social ndikojnë tek personi dhe mjedisi dhe t' i marrë ato parasysh gjatë formimit të një opinionit dhe marrjes së vendimeve;
- » të formulojë dhe argumentojë pikëpamjet e tyre, të dëgjojë dhe analizojë pikëpamjet e të tjerëve dhe t' i trajtojë ata me respekt, edhe kur nuk janë dakord;
- » të analizojnë ndikimin e mediave të shkruara, elektronike dhe sociale në opinionin publik dhe të selekton burime të besueshme informacioni mbi të cilat do të bazojnë pikëpamjet personale.

Koncepti i arsimit fillor nga viti 2020 parashikon që të gjitha kompetencat e përfshira në Standardet Kombëtare të fitohen përmes mësimi të lëndëve mësimore. Disa nga këto njihen në rezultatet e të nxënësve dhe standardet për vlerësim për lëndë të caktuara, veçanërisht kur bëhet fjalë për lëndë që rrjedhin drejtpërdrejt nga fushat e Standardeve Kombëtare. Ekzistojnë gjithashtu kompetenca transversale që përfshihen në programet mësimore përmes aktiviteteve për nxënësit të dizajnuara për të arritur standardet e vlerësimit, pra rezultatet e të nxënësve. Kompetencat e edukimit mediatic mund të gjenden si në një kategori ashtu edhe në tjetrën – një pjesë e tyre mund të lidhet drejtpërdrejt me lëndë specifike, dhe një pjesë tjetër i përket disa lëndëve njëkohësisht.

4

EDUKIMI MEDIATIK NË PROGRAMET MËSIMORE

Kompetencat e arsimimit mediatic që rrjedhin nga Standardet Kombëtare të Arsimit Fillor janë përfshirë në programet mësimore në mënyra të ndryshme. Një mënyrë është me prezantimin e një teme të veçantë kushtuar edukimit mediatic në lëndët: gjuha maqedonase, gjuha shqipe, gjuha turke, gjuha serbe dhe gjuha boshnjake, nga klasa e parë deri në klasën e nëntë. Mënyra tjetër është duke përfshirë një aspekt të veçantë të edukimit mediatic në rezultatet e të nxënësve, përkatësisht në përmbajtjen dhe në standardet për notim në lëndë të tjera në disa klasa. Qasja e tretë përdor edukimin mediatic si një mjet për zbatimin e aktiviteteve të caktuara që shërbejnë për arritjen e standardeve të caktuara të vlerësimit në pothuajse të gjitha lëndët mësimore në klasa të ndryshme. Mënyra e katërt është duke dhënë hapësirë për studim të thelluar të aspekteve të caktuara të edukimit mediatic përmes lëndëve zgjedhore nga klasa e katërt deri në klasën e nëntë.

4.1.

EDUKIMI MEDIATIK SI TEMË E VEÇANTË NË LËNDËT GJUHA MAQEDONASE, GJUHA SHQIPE, GJUHA TURKE, GJUHA SERBE DHE GJUHA BOSHNJAKE

Në të gjitha programet mësimore në lëndët e listuara (klasa I- IX), kompetencat e edukimit mediatic janë të inkorporuara drejtpërdrejt në një temë të veçantë me rezultate të përcaktuara të të nxënësve, përmbajtje dhe standarde të vlerësimit, si dhe shembuj të aktiviteteve për arritjen e standardeve për notim.

Tabelat e mëposhtme tregojnë se si u zhvilluan temat e edukimit mediatic nga klasa e parë deri në klasën e nëntë.

Klasa I

Rezultatet e të nxënësve

Nxënësi/nxënësja duhet të jetë i/ e aftë:

1. të veçojë informacione nga llojet e ndryshme të mediave me ndihmën e mësimitdhënësit;
2. të kuptojnë përmbajtjen e shfaqjes teatrale për fëmijë dhe/ose shfaqjes me kukulla.

Përmbajtja (dhe nocione)	Standardet e vlerësimit
<p>→ Mediat dhe përmbajtje mediatike për fëmijë (filma të animuar, shfaqje televizive, përmbajtje në internet, revista për fëmijë)</p>	<p>→ Veçon informacionin nga përmbajtja mediatike e dëgjuar sipas udhëzimeve të dhëna (teksti nga radio emision, reklama televizive/reklama në radio, film i animuar).</p> <p>→ Veçon informacionin nga përmbajtja mediatike të shkruar sipas udhëzimeve të dhëna (nga broshurë, gazeta/bilbord, revista për fëmijë, teksti i shkarkuar nga interneti).</p> <p>→ Bën pyetje në lidhje me përmbajtjen mediatike që ka parë (film i animuar/shfaqje televizive).</p>
<p>→ Ngjarje kulturore (teatër për fëmijë, shfaqje kukullash)</p>	<p>→ Tregon përmbajtjen e shfaqjes pas pyetjeve të dhëna.</p>

Klasa e II-të

Rezultatet e të nxënit

Nxënësi/nxënësjja duhet të jetë i/ e aftë:

1. të dallojnë dhe tregojë lloje të ndryshme të mediave;
2. të kuptojë mesazhet mediatike dhe të bëjë dallimin ndërmjet raportimit, reklamimit dhe dhënies së udhëzimeve;
3. të identifikojë dhe interpretojë informacione dhe mesazhe në përmbajtje tekstuale, figurative dhe digjitale për njoftim, udhëzim dhe reklamim;
4. të krijojë mesazhe të shkurtra mediatike për raportim, udhëzim dhe reklamim.

Përmbajtja (dhe nocione)	Standardet e vlerësimit
→ Llojet e mediave (media e shkruar, media vizuale, internet - media)	→ Paraqet burimet e mesazheve dhe përmbajtjes mediatike (revistë, radio, televizion, billboard, poster, fletëpalosje, internet - media, telefon celular).
→ Llojet e mesazheve mediatike (njoftim, udhëzim, reklamë)	→ Shënon burimet e mesazheve mediatike (revistë, radio, televizion, billboard, poster, fletëpalosje, internet, telefon celular). → Bën dallim mes mesazheve mediatike për raportim, udhëzim dhe reklamim. → Nxjerr informacione të rëndësishme nga lloje të ndryshme të mesazheve mediatike.
→ Interpretimi dhe përdorimi i përmbajtjes mediatike	→ Identifikon një mesazh kyç në përmbajtjen e mediave tekstuale të shkruara me shkronja me madhësi/trashësi të ndryshme dhe/ose me ngjyra të ndryshme. → Identifikon një mesazh kyç në përmbajtjen mediatike me ilustrime sipas madhësisë, pozicionit dhe ngjyrës së objekteve të shfaqura. → Njeh rëndësinë e ikonave digjitale (emotikon, gif dhe meme) në aplikacionet celulare dhe kompjuterike. → Krijon fjalë kyçe dhe fraza dhe zgjedh ilustrime të përshtatshme dhe ikona digjitale si bazë për një mesazh mediatik.
→ Krijimi i mesazheve dhe përmbajtjeve mediatike	→ Zgjedh përmbajtje mediatike për prezantim të koncepteve dhe përpunim të temave. → Përpilon mesazh të shkurtër mediatik në formën e një reklame, udhëzimi dhe informacioni.

Klasa e III-të

Rezultatet e të nxënit

Nxënësi/nxënësjja duhet të jetë i/ e aftë:

1. të citojë shembuj për të shpjeguar/përshkruar se si media ndikon tek përdoruesit;
2. të shpjegojë se si një telefon celular përdoret në mënyrë të sigurt për qasje në informacione përmes aplikacioneve;
3. të kërkojë dhe të gjejë informacionin e nevojshëm në internet nëpërmjet përdorimit të fjalëve kyçe;
4. të krijojë përmbajtje të thjeshtë mediatike duke lidhur tekstin me ilustrimet.

Përmbajtja (dhe nocione)	Standardet e vlerësimit
→ Ndikimi i mediave (informacione problematike dhe udhëzuese, përmbajtje manipuluese)	<ul style="list-style-type: none">→ Bën dallim midis informacionit problematik dhe udhëzues në përmbajtjet mediatike.→ Shpjegon (përmes shembullit) se si përmbajtje mediatike ndikon në emocionet e përdoruesve.→ Identifikon përmbajtje manipuluese në media.
→ Përdorimi i telefonit celular (pajisje inteligjente, aplikacione për telefon/ pajisje inteligjente, ikona, emotikon)	<ul style="list-style-type: none">→ Specifikon aplikacionet në telefon celular/pajisje inteligjente që janë të dobishme dhe të sigurta për përdorim.→ Shpjegon (përmes shembullit) dallimin midis përdorimit të përgjegjshëm dhe të papërgjegjshëm të një telefoni celular.→ Shpjegon (përmes shembullit) pse fjalëkalimi i telefonit nuk duhet të ndahet me të tjerët.→ Shpjegon (përmes shembullit) dallimin midis komunikimit celular të përgjegjshëm dhe të papërgjegjshëm (përmes bisedës ose mesazheve).→ Ilustron mesazh me tekst me emotikon përkatës.
→ Kërkim në internet (linqe, fjalë kyçe, Google)	<ul style="list-style-type: none">→ Shpjegon (përmes shembullit) se çfarë është interneti.→ Përcakton fjalët kyçe në fjali dhe në tekste të shkurtra.→ Gjen informacionin e nevojshëm në internet përmes një kërkimi në Google.
→ Krijimi i përmbajtjeve mediatike të thjeshta	<ul style="list-style-type: none">→ Përdor mënyra të ndryshme për prezantim të informacioneve (tekst, imazh/fotografi, video).→ Krijon përmbajtje mediatike për një temë të caktuar të përbërë nga teksti dhe një imazh, fotografi ose video.

Klasa e IV- të

Rezultatet e të nxënit

Nxënësi/nxënësja duhet të jetë i/ e aftë:

1. të kërkojë, të veçojë dhe të përdorë informacione nga media të ndryshme;
2. të bëjë dallimin midis realitetit offline dhe atij online;
3. të shpjegojë përfitimet dhe sfidat nga luajtja e video-lojërave;
4. të kuptojë dhe të përcjellë mesazhin e një ngjarjeje kulturore (që ka vizituar ose që do të vizitojë);

Nxënësi/nxënësja është i vetëdijshëm/e vetëdijshme për:

5. ndikimin negativ nga përdorimi i pakufizuar i mediave online në kohën e lirë.

Përmbajtja (dhe nocione)	Standardet e vlerësimit
→ Informacione nga media të ndryshme	<ul style="list-style-type: none">→ Gjen informacione nga media të ndryshme për nevojat/interesat e veta.→ Dallon informacione (sipas kërkesave të dhëna) të shfaqura në media të ndryshme (televizion, internet, revistë, etj.).→ Përdor informacione nga media të ndryshme për të krijuar tekste të personalizuar për një temë të caktuar.
→ Offline dhe online realiteti (qasja në informacione, përditësimi, interaktiviteti, lidhja globale)	<ul style="list-style-type: none">→ Tregon dhe shpjegon (përmes shembujve) dallimet midis realitetit offline dhe atij online në mënyrën e komunikimit dhe qasjes në informacion.→ Tregon dhe shpjegon (përmes shembujve) përparësitë e online përmbajtjeve.
→ Video-lojërat si një lloj mediumi (video-lojëra me aksion, aventura, luajtja e roleve, strategji, simulim, sport; dhunë dhe agresion, varësi, izolim, pasivitet fizik; argëtim dhe relaksim, shpejtësia e reagimit, zgjidhja e problemeve, kreativitet)	<ul style="list-style-type: none">→ Tregon shembuj të video lojërave që janë të ndryshme në përmbajtje.→ Tregon dhe shpjegon (përmes shembujve) efektet negative të luajtjes së video lojërave.→ Tregon dhe shpjegon (përmes shembujve) anët pozitive të luajtjes së video lojërave.
→ Ngjarje kulturore	<ul style="list-style-type: none">→ Shpjegon përmbajtjen dhe idenë e një ngjarjeje kulturore të cilën e ka ndjekur.→ Shpreh mendim personal për një ngjarje kulturore ku ka marrë pjesë dhe jep një shpjegim se pse mendon kështu.→ Krijon një poster ftese/reklamë për një ngjarje kulturore në shkollë ose komunitet.

Klasa e V-të

Rezultatet e të nxënit

Nxënësi/nxënësja duhet të jetë i/ e aftë:

1. të dallojë mediat tradicionale dhe digjitale dhe shpjegojnë avantazhet dhe disavantazhet e tyre;
2. të dallojë faktet dhe opinionet në përmbajtjet mediatike dhe të krijojë përmbajtje mediatike duke përdorur fakte dhe opinione;
3. të përdorë mënyra të thjeshta për të verifikuar informacionin dhe fotografitë nga interneti.
- 4.

Nxënësi/ nxënësja do të zhvillojë vetëdije për:

5. pasojat e përdorimit të tepruar të rrjeteve sociale;
6. nevojën për të verifikuar vërtetësinë e informacionit në internet dhe rrjetet sociale.

Përmbajtja (dhe nocione)	Standardet e vlerësimit
<ul style="list-style-type: none">→ Media tradicionale dhe mediat digjitale→ Mediat sociale	<ul style="list-style-type: none">→ I përshkruan ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet mediave tradicionale dhe mediave digjitale.→ I shpjegon përparësitë dhe mangësitë e përdorimit të internetit gjatë kërkimit të përmbajtjeve.→ I shpjegon përparësitë dhe mangësitë e mediave sociale.
<ul style="list-style-type: none">→ Fakte dhe opinione (informacion, lajm, intervistë, informacion i rremë/dezinformatë)	<ul style="list-style-type: none">→ Bën dallimin ndërmjet përcjelljes së fakteve dhe shprehjes së një qëndrimi/opinionit personal në përmbajtje mediatike.→ Krijon lajm të shkurtër në lidhje me një ngjarje;→ Krijon përmbajtje mediatike përmes së cilës përcillen fakte ose/dhe opinione.→ Krijon pyetje të thjeshta për të kryer një intervistë.→ Përdor mënyra të thjeshta për të kontrolluar besueshmërinë e përmbajtjeve mediatike në internet.

Klasa e VI-të

Rezultatet e të nxënit

Nxënësi/nxënësja duhet të jetë i/ e aftë:

1. të bëjë dallimin midis lajmeve dhe opinioneve;
2. të shpjegojë rolin e gazetarisë dhe nevojën për respektimin e standardeve etike (paanshmëri dhe balancimi);
3. të shpjegojë rëndësinë e lirisë së shprehjes dhe respektimin e standardeve etike të sjelljes në hapësirën digjitale;
4. të njohë gjuhën e urrejtjes në media dhe të emërojë strategjitë për luftë kundër gjuhës së urrejtjes.

Nxënësi/ nxënësja do të zhvillojë vetëdije për:

5. sjelljen etike në komunikimin online;
6. ndikimin e mesazheve dhe përmbajtjeve mediatike mbi opinionin e përdoruesve.

Përmbajtja (dhe nocione)	Standardet e vlerësimit
<p>→ Roli i gazetarisë (lajme, opinione, gazetar, gazetari, standardet etike, paanshmëria dhe balancimi)</p>	<p>→ Tregon shembuj të përmbajtjeve informative dhe shembuj për përmbajtje në të cilat shprehen mendime.</p> <p>→ Shpjegon rolin e gazetarisë në shoqëri.</p> <p>→ Shpjegon kuptimin e paanshmërisë dhe balancimit si standarde etike.</p>
<p>→ Liria e shprehjes dhe sjellja etike në hapësirën digjitale (fyerjet personale dhe shpifjet, respektimi i privatësisë)</p>	<p>→ Shpjegon rëndësinë e lirisë së shprehjes në krijimin dhe shkëmbimin e përmbajtjes mediatike.</p> <p>→ Njih fyerjet personale dhe shpifjet në komunikimin online.</p> <p>→ Njih shkeljen e të drejtës së privatësisë në komunikimin online.</p> <p>→ Shpjegon pasojat e sjelljes joetike në hapësirën digjitale.</p>
<p>→ Stereotipet dhe gjuha e urrejtjes në media dhe në rrjetet sociale (stereotipet gjinore, stereotipet e moshës, stereotipet racore, stereotipet profesionale, gjuha e urrejtjes)</p>	<p>→ Njih stereotipet në media.</p> <p>→ Shpjegon se si stereotipet në mediat shtrembërojnë të vërtetën.</p> <p>→ Shpjegon pasojat e përhapjes së stereotipeve përmes mediave dhe rrjeteve sociale.</p> <p>→ Njih gjuhën e urrejtjes në media dhe në rrjetet sociale.</p> <p>→ Shpjegon se çfarë është gjuha e urrejtjes.</p> <p>→ Shpjegon pasojat e përdorimit të gjuhës së urrejtjes në media dhe në rrjetet sociale.</p> <p>→ Përshkruan strategjitë për të luftuar gjuhën e urrejtjes.</p>

Klasa e VII- të

Rezultatet e të nxënit

Nxënësi/nxënësja duhet të jetë i/ e aftë:

1. të identifikojë dhe shpjegojë dezinformimin dhe manipulimin në hapësirën mediatike;
2. të identifikojë rreziqet gjatë komunikimit në rrjetet sociale;
3. të marrë në konsideratë pasojat e ndikimit të rrjeteve sociale në formimin e imazhit për trupin;
4. të bëjë një analizë të thjeshtë të përmbajtjes mediatike.

Nxënësi/ nxënësja do të zhvillojë vetëdije për:

5. pasojat e përhapjes së dezinformimit dhe përdorimit të manipulimit në media;
6. rrezikun e mundshëm të mediave sociale për sigurinë dhe mirëqenien e të rinjve.

Përmbajtja (dhe nocione)	Standardet e vlerësimit
<p>→ Dezinformata dhe manipulime (informata të gabuara/misinformata, dezinformata dhe informacione të dëmshme/malinformata; dezinformata vizuale, manipulimi emocional)</p>	<p>→ Shpjegon llojet e ndryshme të informacionit manipulues të publikuar në hapësirën mediatike.</p> <p>→ Tregon shembuj të manipulimit të përmbajtjes vizuale.</p> <p>→ Shpjegon përmes një shembulli se si përdoret përmbajtja vizuale për manipulimin emocional.</p>
<p>→ Rreziqet në rrjetet sociale (mbrojtja e të dhënave personale, reklamimi i fshehur, profili i rremë, bot)</p>	<p>→ Shpjegon mënyrat për të mbrojtur të dhënat personale në internet.</p> <p>→ Njih reklamat e fshehura në përmbajtje të ndryshme mediatike.</p> <p>→ Shpjegon mënyrën e njohjes së një profili të rremë në rrjet social.</p> <p>→ Specifikon karakteristikat e botit.</p> <p>→ Identifikon shenjat më të zakonshme të profileve të rreme dhe boteve në rrjetet sociale.</p>
<p>→ Mediat sociale dhe imazhi për trupin</p>	<p>→ Shpjegon, përmes shembujve, se si përfaqësimi i trupave meshkuj dhe femra në mediat sociale ndikon mbi formimin e imazhit për trupin.</p> <p>→ Shpjegon se si imazhi i trupit "ideal" të përfaqësuar përmes medias ndikon në vetëvlerësimin dhe mirëqenien e të rinjve.</p> <p>→ Specifikon strategjitë për ballafaqim me presionin që ushtrojnë mediat në lidhje me imazhin e trupit.</p>

- Përmbajtje mediatike për informim dhe bindje (raportim mediatik, opinion, reklamim, reklamim social, marrëdhënie me publikun, propagandë)
- Analiza e përmbajtjeve mediatike (komponentët e përmbajtjes mediatike, objektivi i mesazhit mediatik, teknikat e tërheqjes së vëmendjes)

- Identifikon përmbajtje mediatike të destinuara për informim (raportim mediatik).
- Bën dallim midis llojeve të ndryshme të përmbajtjeve mediatike të destinuara për bindje (opinion, reklamim, reklamim social, marrëdhëniet me publikun, propagandë).
- Zbulon se kush e ka krijuar përmbajtjen mediatike dhe për çfarë qëllimi.
- Shpjegon komponentët e përmbajtjes mediatike (fjalë, muzikë, ngjyra, lëvizje, këndi i incizimit, etj.) dhe se si ato kontribuojnë në arritjen e qëllimit të mesazhit mediatik.
- Identifikon se cilat teknika të tërheqjes së vëmendjes janë përdorur në përmbajtjen mediatike.
- Shpjegon përmes shembujve se si besimet, interesat dhe përvojat e njerëzve ndikojnë në interpretimin e përmbajtjes mediatike.
- Njih vlera dhe pikëpamje që paraqiten në një mesazh të caktuar mediatik dhe cilat anashkalohen.
- Njih përmbajtjen propagandistike dhe manipuluese në mesazhet mediatike.

Klasa e VIII-të

Rezultatet e të nxënësve

Nxënësi/nxënësja duhet të jetë i/ e aftë:

1. të shpjegojë se si manipulohet përmbajtja mediatike përmes titujve;
2. të kontrollojë besueshmërinë e informacionit tekstual dhe vizual në përmbajtjen mediatike;
3. të krijojë përmbajtje mediatike dhe të shpjegojë se si shpërndahet me përgjegjësi.

Nxënësi/ nxënësja do të zhvillojë vetëdije për:

4. pasojat e ndarjes së papërgjegjshme të përmbajtjes mediatike.

Përmbajtja (dhe nocione)	Standardet e vlerësimit
→ Titujt dhe karremat për klikime ("klikbejt")	<ul style="list-style-type: none"> → Tregon shembuj të titujve manipulues dhe sugjerues. → Shpjegon (përmes shembujve) se si janë formuluar titujt e përmbajtjes mediatike për të "gjuajtur" klikime.
→ Verifikimi i besueshmërisë së informacionit dhe përmbajtjes mediatike (verifikimi, besueshmëria, burimi kryesor i informacionit)	<ul style="list-style-type: none"> → Përdor mjete dhe aftësi për të verifikuar vërtetësinë e përmbajtjes vizuale. → Përdor hapat për të kontrolluar besueshmërinë e një përmbajtjeje të caktuar mediatike në mediat tradicionale dhe në internet. → Tregon hapat për kontrollim të besueshmërisë së përmbajtjes mediatike. → Kontrollon datën e publikimit, burimin e informacionit, vërtetësinë e citimeve dhe besueshmërinë e të dhënave/provave në përmbajtjen mediatike në internet për të përcaktuar besueshmërinë e lajmit. → Përcakton besueshmërinë e burimit të informacionit. → Përdor mjete të ndryshme online për të verifikuar përmbajtjen në internet.
→ Krijimi dhe ndarja e përmbajtjes mediatike me përgjegjësi	<ul style="list-style-type: none"> → Krijon përmbajtje mediatike: formulon tituj jo manipulues, përdor burime të besueshme dhe citime të besueshme dhe siguron të dhëna/prova të sakta. → Shpjegon se çfarë do të thotë të ndash informacione me përgjegjësi përmes rrjeteve sociale. → Tregon pasojat e mundshme të shkëmbimit të papërgjegjshëm të informacionit.

Klasa e IX-ë

Rezultatet e të nxënit

Nxënësi/nxënësja duhet të jetë i/ e aftë:

1. të vlerësojë besueshmërinë e një përmbajtjeje të caktuar mediatike për shkencën dhe shëndetin, duke përdorur tregues për zbulimin e dezinformatave;
2. të përcaktojë besueshmërinë e burimeve që lidhen me shkencën dhe shëndetin të pranishëm në mediat online dhe rrjetet sociale;
3. të krijojnë përmbajtje mediatike në fushën e shkencës dhe shëndetit dhe të shpjegojnë se si ato shpërndahen me përgjegjësi përmes mediave dhe rrjeteve sociale;
4. të shpjegojë se si funksionojnë algoritmet.

Nxënësi/nxënësja do të zhvillojë:

5. vetëdije për pasojat e dëmshme nga besimi në informacione të pa verifikuara që lidhen me shkencën dhe shëndetin;
6. qasje kritike ndaj përmbajtjes që i ofrohet në internet.

Përmbajtja (dhe nocione)	Standardet e vlerësimit
→ Dezinformata për shkencën dhe shëndetin	<ul style="list-style-type: none"> → Tregon indikatorë që sugjerojnë praninë e dezinformatave në përmbajtjet mediatike për shkencë dhe shëndet. → Kontrollon nëse përmbajtja mediatike në lidhje me shkencën dhe shëndetin përmban dezinformata.
→ Besueshmëria e informacioneve dhe kredibiliteti i burimeve në lidhje me shkencën dhe shëndetin të pranishme në mediat online dhe rrjetet sociale	<ul style="list-style-type: none"> → Përcakton kredibilitetin e burimit të informacionit në lidhje me shkencën dhe shëndetin. → Shpjegon pse prodhuesit e ilaçeve, vitaminave dhe kozmetikës japin informacion të rremë në lidhje me produktet e tyre. → Liston pasojat e dëmshme nga dhënia e informacionit të pa verifikuar dhe të rremë në lidhje me ilaçet, vaksinat dhe bimët mjekësore. → Zbaton mjete të ndryshme në internet për verifikimin e përmbajtjes mediatike në lidhje me shkencën dhe shëndetin.
→ Krijimi dhe ndarja e përmbajtjes mediatike në lidhje me shkencën dhe shëndetin	<ul style="list-style-type: none"> → Identifikon burim të besueshëm informacioni për krijimin e përmbajtjes mediatike për një temë të caktuar në lidhje me shkencën dhe shëndetin. → Përdor citime dhe të dhëna/prova dhe informacione të tjera të besueshme nga burime të besueshme kur krijojnë përmbajtje mediatike për një temë të caktuar në lidhje me shkencën dhe shëndetin. → Shpjegon se çfarë do të thotë të ndash me përgjegjësi informacionin shkencor dhe shëndetësor përmes mediave dhe rrjeteve sociale.
→ Algoritmet e mediave sociale	<ul style="list-style-type: none"> → Shpjegon se si funksionojnë algoritmet e mediave sociale. → Shpjegon se si algoritmet gjurmojnë shprehjet dhe preferencat e përdoruesve dhe ofrojnë përmbajtje, informacion dhe shërbime të përshtatura.

4.2. EDUKIMI MEDIATIK SI TEMË E VEÇANTË NË ARSIMIN TEKNIK DHE INFORMATIKË

Aspekte të caktuara të edukimit mediatik janë të inkuorporuara në rezultatet e të nxënimit, përkatësisht në përmbajtjet dhe standardet për vlerësim në lëndën Arsimit teknik dhe informatika. Tabela e mëposhtme mund të përdoret si shembull:

Lënda: Arsimit teknik dhe informatikë (klasa e V-të)

Tema: Siguria në internet

Rezultatet e të nxënimit

Nxënësi/nxënësja duhet të jetë i/ e aftë:

- » të përshkruajnë rreziqet gjatë përdorimit të internetit dhe rrjeteve sociale dhe përshkruajnë mënyrat për përdorimin e tyre me përgjegjësi dhe siguri.

Nxënësi/nxënësja do të zhvillojë:

- » ndërgjegjësim se përdorimi i përgjegjshëm i internetit dhe rrjeteve sociale kontribuon në mbrojtjen e privatësisë, reputacionit dhe sigurisë personale.

Përmbajtja (dhe nocione)	Standardet e vlerësimit
<ul style="list-style-type: none">→ Përdorimi i sigurt i internetit (Interneti, rrjetet sociale, komunikimi online, ueb faqe, të dhëna personale, viruse, programe antivirus)	<ul style="list-style-type: none">→ Përshkruan rreziqet dhe sfidat në lidhje me kërkimin në internet.→ Përshkruan mënyrat e përdorimit të internetit në mënyrë të përgjegjshme dhe të sigurt.→ Përshkruan rreziqet e sigurisë dhe mundësitë e keqpërdorimit gjatë komunikimit në internet.→ Tregon mënyrat për të komunikuar me përgjegjësi dhe siguri përmes internetit.
<ul style="list-style-type: none">→ Komunikimi i sigurt në rrjetet sociale (rregulla për online siguri, ueb faqe)	<ul style="list-style-type: none">→ Shpjegon rregullat për përdorimin e sigurt të internetit dhe shpjegon pasojat e shkëmbimit të informacionit privat në internet.→ Shpjegon mënyrat se si të jetë pjesë e World Wide Web në mënyrë të sigurt, dhe se si të mbrojnë të dhënat e tyre personale.→ Përshkruan pasojat e shpërndarjes së informacioneve private në internet.

4.3. EDUKIMI MEDIATIK NË AKTIVITETET PËR ARRITJEN E REZULTATEVE TË TË NXËNIT NË LËNDË TË NDRYSHME

Qasja e tretë përdor edukimin mediatik si një mjet për zbatimin e aktiviteteve të caktuara që shërbejnë për arritjen e standardeve të caktuara të vlerësimit në pothuajse të gjitha lëndët mësimore në klasa të ndryshme. Kështu, kompetenca të caktuara nga edukimi mediatik fitohen përmes përdorimit dhe/ose krijimit të përmbajtjes mediatike për nevojat e një lënde specifike.

Tabelat e mëposhtme japin shembuj për të ilustruar këtë qasje.

Lënda: Shoqëri (Klasa e II-të)

Tema: Në shkollë

Shembuj të aktiviteteve

- Nxënësit vihen në rolin e gazetarëve. Tërheqin karta në të cilat janë shënuar profesionet e punonjësve të shkollës (drejtor/drejtores, psikolog, defektolog, pedagog, higjienist/higjieniste, etj.). Secili grup tërheq një ose dy karta dhe sipas profesioneve nga kartat, përpilojnë pyetje për intervistë me punonjësit nga profesioni përkatës që u ka rënë në kartë. Secili grup cakton një nxënës gazetar për të udhëhequr intervistën, një nxënës fotograf (i cili do të bëjë fotografi me një aparat fotografik digjital) dhe një nxënës asistent i cili do të marrë shënime. Pas kryerjes së intervistës, secili grup prezanton para gjithë klasës. Nxënësit perceptojnë ngjashmëritë dhe dallimet midis profesioneve dhe njohin nevojën për këto profesione. Nga të dhënat e marra përpilohet një libër i përbashkët, i cili u paraqitet punonjësve të shkollës.
- Ndërlidhje me aktivitetin e mëparshëm: Mësimdhënësi përzgjedh disa karakteristika nga secili profesion dhe shton disa informacione të pasakta në përshkrimet e përgatitura nga nxënësit. Nxënësit kanë për detyrë të njohin informacionin e rremë dhe të shpjegojnë pse është i pasaktë. Mësimdhënësi shpjegon përmes një diskutimi se ndonjëherë ndodh që në informacionet që vijnë deri te ne, ka edhe informata të gabuara ose jo mjaft të sakta. Bashkërisht konkludohet se është e nevojshme të verifikohet saktësia e informacionit përpara se t'i besohet.
- Nxënësit duhet të përshkruajnë një video lojë ose të tregojnë një film që përmban skena dhune. Disa nxënës aktrojnë disa nga skenat, dhe pas shfaqjes mësimdhënësi i pyet ata se çfarë do të ndodhte nëse skena nuk do të ishte një shfaqje, një film ose një video lojë, por do të ishte e vërtetë. Nxënësit përfundojnë përmes diskutimit se pasojat në jetën reale janë të ndryshme nga pasojat në TV ose në një video lojë (për shembull, ndërsa në video lojëra, personi që vdes mund të "kthehet në jetë përsëri" vetëm duke shtypur një buton, në realitet, nëse dikush na godet, mund të na lëndojë, të na bëjnë të qajmë ose madje mund të kemi nevojë për ndihmë mjekësore).
- Nxënësit, të ndarë në grupe, vizatojnë një strip komik (nga tre deri në katër skena) përmes të cilit përshkruajnë komunikimin e dhunshëm që zgjidhet në mënyrë jo të dhunshme. Më poshtë është një prezantim dhe diskutim që dënon komunikimin e dhunshëm midis nxënësve.

Lënda: Shoqëri (Klasa e III-të)

Tema: E dua vendin tim

Shembuj të aktiviteteve

- Në disa orë të njëpasnjëshme, nxënësit (të ndarë në grupe) bëjnë libra me titull “E dua vendin tim”. Secili grup hulumton për secilën nga temat e mëposhtme në internet (ata gjithashtu mund të përdorin Google Earth), të zgjedhin fotografi për librin dhe të shkruajnë tekste shumë të shkurtra sipas kërkesave të mëposhtme:
 1. Për Liqenin e Ohrit, Prespës dhe Dojranit, shkruajnë një tekst të shkurtër në të cilin i krahasojnë në madhësi, i ilustrojnë me fotografi dhe i ngjyrosin me shënues në hartën e Republikës së Maqedonisë së Veriut.
 2. Për Korabin, Malin e Sharrit dhe Babën shkruajnë një tekst të shkurtër në të cilin i krahasojnë në lartësi, i ilustrojnë me fotografi dhe i rrethojnë me shënues në hartën e Republikës së Maqedonisë së Veriut.
 3. Për Vardarin, shkruajnë një tekst se nga buron dhe nëpër cilat qytete kalon, e tregojnë lumin përmes fotografive dhe në hartën e Republikës së Maqedonisë së Veriut e shënojnë me një shënues dhe rrethojnë qytetet nëpër të cilat rrjedh.
 4. Për Mavrovën, Galiçicën, Pelisterin dhe Malin Sharr shkruajnë tekst të shkurtër, me të cilin shpjegojnë pse janë parqe kombëtare dhe për çfarë janë më të famshme dhe i ilustrojnë me fotografi.
-

Lënda: Histori dhe shoqëri (klasa e IV)

Tema: Mjedisit ku jetoj

Shembuj të aktiviteteve

- Nxënësit, të ndarë në grupe të vogla, prodhojnë postera ose prezantime multimediale për fushata reklamuese të dedikuara për përmirësimin e mjedisit në komunë (për ajër/ujë të pastër, për seleksionimin e mbeturinave, për kursimin e energjisë elektrike, për shtigjet e biçikletave, për hedhjen e mbeturinave në vendet e destinuar për këtë, etj.).
 - Nxënësit, të ndarë në grupe, eksplorojnë të dhëna online për karakteristikat e komunës. I përdorin të dhënat e marra për të bërë një broshurë për komunën (me grafikë mbi strukturën e popullsisë, ilustrime mbi burimet natyrore dhe trashëgiminë kulturore, tekst mbi aktivitetet ekonomike të përfaqësuara dhe mbrojtjen e mjedisit). Gjithashtu mund të përgatisin një prezantim multimedial.
 - Nxënësit përgatisin postera të vegjël që përmbajnë: 1) ilustrim të sjelljes së papërgjegjshme ndaj mjedisit të vendosur në një shenjë STOP dhe 2) mesazh me tekst për mbrojtjen e mjedisit. Posterat i vendosin në oborrin e shkollës.
-

Lënda: Shkenca natyrore (Klasa IV)

Tema: Karakteristikat fizike të Tokës

Shembuj të aktiviteteve

- Nxënësit përdorin të dhëna nga interneti në lidhje me kushtet e motit në tre vitet e fundit për një qytet që ndodhet në veri dhe një qytet që ndodhet në jug të globit, kështu që krahasojnë elementet e klimës dhe rendisin faktorët që kontribuojnë në dallimet.
 - Nxënësit, të ndarë në grupe të vogla, prodhojnë postera me përmasa për mbrojtjen e burimeve natyrore.
-

Lënda: Arsim figurativ (klasa IV)

Tema: Dizajn dhe komunikime vizuale

Shembuj të aktiviteteve

- Nxënësit projektojnë një strip komik, duke përdorur copa të prera nga gazetat e vjetra ose fotografi të personazheve të preferuar.
 - Nxënësit krijojnë një dizajn të kopertinës (nga një libër, libër komik, broshurë, revistë, etj.) sipas një teksti që përpunohet në lëndën e gjuhës amtare. Si mjet për shprehje, përdorin kompjuterin.
 - Nxënësit bëjnë spot dhe/ose reklamë në nivelin e shkollës, duke përdorur kompjuter dhe pajisje të tjera digjitale për dizajn.
-

Lënda: Arsim muzikor (klasa e V-të)

Tema: Dëgjojmë muzikë

Shembuj të aktiviteteve

- Mësimdhënësi së pari paraqet një film të shkurtër të animuar pa sfond muzikor, dhe pastaj edhe një herë, por këtë herë së bashku me muzikën. Nxënësit e lidhin muzikën me përmbajtjen e filmit të animuar dhe diskutojnë se si e përjetuan atë në të dyja situatat (me ose pa muzikë). E njëjta procedurë përsëritet edhe për filmat e tjerë të animuar.
 - Mësimdhënësi paraqet inserte nga filmat artistikë (p.sh., "IT", "101 Dalmatët") dhe filma me metrazh të gjatë (p.sh., "Mbreti luan", "E bukura dhe Bisha") të shoqëruara me muzikë. Nxënësit diskutojnë ndikimin e muzikës në amplifikimin e efekteve që priten të arrihen në skenat e listuara. Pastaj lëshohen kompozimet muzikore sipas të cilave njihen filmat, insertet e të cilëve janë dëgjuar më parë dhe nxënësit diskutojnë se si i përjetojnë ato.
 - Nëpërmjet prezantimit të audio-video incizimeve, nxënësit prezantohen me baletin dhe muzikalët si pjesë skenike muzikore. Pastaj diskutojnë muzikën e dëgjuar, rolin e saj në vetë veprën dhe nxjerrin në pah dallimet midis dy llojeve të veprave skenike.
 - *Shembull i një aktiviteti të projektit me integrimin e muzikës, gjuhës amtare dhe informatikës/programimit:* nxënësit shikojnë një film të animuar, diskutojnë karakterin e personazheve dhe rrjedhën e veprimit. Pastaj kanë për detyrë të gjejnë shembuj muzikorë të përshtatshëm për personazhet dhe veprimin dhe t'i përputhin ato me videon përmes një programi kompjuterik.
-

4.4. EDUKIMI MEDIATIK PËRMES LËNDËVE ZGJEDHORE

Studimi i thelluar i aspekteve të caktuara të edukimit mediatic bëhet i mundur përmes lëndëve zgjedhore të ofruara nga klasa e katërt deri në klasën e nëntë për të mbështetur dhe/ose inkurajuar interesin e nxënësve në zhvillimin e kompetencave specifike të edukimit mediatic përmes zbatimit të tyre në fusha të caktuara.

Mësimdhënësit në shkolla zhvillojnë programet mësimore për lëndë mësimore zgjedhore për nevojat e nxënësve të tyre ose ofrohen nga Byroja për Zhvillimin e Arsimit, si një mundësi që të përdoren në të gjitha shkollat. Si shembuj të lëndëve zgjedhore, nga fusha e edukimit mediatic, mund të shërbejnë:

- GAZETARË DHE LAJME
- REKLAMIM ONLINE
- KOMUNIKIMET VIZUALE
- PËRFAQËSIMI MULTIMEDIAL.

5

KOMPETENCAT E MËSIMDHËNËSVE PËR ZHVILLIMIN E EDUKIMIT MEDIATIK MIDIS NXËNËSVE

Si kurrë më parë, sot diskutohet për dëmet në segmente të ndryshme të shoqërisë të shkaktuara nga shpërndarja e dezinformatave përmes mediave të ndryshme dhe aktualizohet shqetësimi për standardet dhe vlerat në diskursin tonë të përditshëm mediatik. Në këtë kontekst, interesi për edukimin mediatik dhe arsimin mediatik nga pothuajse marginal po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm, pasi realiteti thekson rëndësinë e përvetësimit të aftësive dhe qëndrimeve të shëndetshme të të rinjve në mënyrë që ata të mund të lundrojnë dhe “mbijetojnë” me sukses në hapësirën gjithnjë e më komplekse mediatike.

Arsimi për edukim mediatik gjithnjë e më shumë shihet si një nevojë për të zhvilluar një sërë kompetencash që shkojnë përtej njohurive të thjeshta se si të përdoren mjetet dhe platformat dhe përfshin kompetenca që marrin parasysh aftësitë dhe qëndrimet që lidhen me fitimin e përgjegjësisë personale, qytetare dhe politike, si dhe promovimin e besueshmërisë, drejtësisë, integritetit, lirisë së fjalës dhe respektimit të të drejtave të njeriut. Për këtë arsye, përshtatja e mësimdhënies me nevojat e botës së informacionit digjital duhet të përqendrohet në fuqizimin e të rinjve për të mbledhur informacionin përkatës dhe për të marrë vendime të mirë-informuara. Prandaj, inkorporimi i edukimit mediatik në arsim nuk mund të reduktohet në modernizimin e programeve mësimore ose miratimin e programeve mësimore të reja. Në qendër të ndryshimeve duhet të jenë mësimdhënësit që posedojnë kompetencat që duhet të zhvillojnë tek nxënësit gjatë procesit arsimor. Në mënyrë që të jenë në gjendje të

zhvillojnë edukimin mediatik midis nxënësve, vetë mësimdhënësit duhet të jenë të edukuar mediatikisht. Për këtë qëllim, mësimdhënësit duhet të kenë kompetenca që mundësojnë:

1. njohjen e sektorit mediatik dhe të gazetarisë profesionale dhe njohjen dhe të kuptuarit e vlerës së raportimit objektiv dhe etik;
2. kërkimin dhe gjetjen e informacionit të besueshëm, përdorimin e burimeve parësore, dallimin midis fakteve dhe opinioneve, kuptimin e rëndësisë së plagjiaturës, integritetit akademik dhe të drejtës së autorit;
3. mendim kritik dhe analitik që synon gjykimet të arsyeshme dhe të pavarura, bazuar në peshimin e kujdesshëm dhe interpretimin e saktë të informacionit që përmban fakte, opinione dhe pikëpamje;
4. analizimi, verifikimi dhe interpretimi i përmbajtjes vizuale (foto, video, infografikë, meme, postera, simbole, logo, etj.);
5. praktikimi i tolerancës sociale përmes komunikimit etik online dhe offline, njohja dhe reagimi ndaj gjuhës së urrejtjes dhe stereotipeve dhe paragjykimeve të pranishme në mesazhet mediatike;
6. garantimi i sigurisë digjitale duke respektuar privatësinë në internet dhe ndërtimin e rezistencës ndaj ngacmimit kibernetik;
7. përdorimi i qasjes inovative dhe krijuese gjatë krijimit të mesazheve mediatike me respekt të plotë për rregullat etike për përdorimin e përgjegjshëm të mjeteve digjitale; dhe
8. identifikimi i pranisë së propagandës, informacionit të rremë dhe dezinformimit në përmbajtjen dhe mesazhet mediatike dhe ndërtimin e rezistencës ndaj manipulimit në hapësirën mediatike.¹⁶

Kjo do të thotë që të gjithë mësimdhënësit, gjatë arsimit fillestar dhe/ose si pjesë e zhvillimit të tyre

¹⁶ Përshtatur nga programi „Mësojmë të njohim“ (*Learn to Discern*) e IREX Global Media and Information Literacy.

profesional, pavarësisht nga lënda që ligjërojnë dhe klasa/viti në të cilin japin mësim, duhet t'i nënshtrohen trajnimit për të fituar kompetenca për edukim mediatik. Trajnimi duhet të mbulojë temat e mëposhtme:

- funksionimin e mediave dhe ofruesve të tjerë të informacionit;
- të kuptuarit, organizimi dhe vlerësimi i informacionit;
- verifikimi i vërtetësisë së informacionit;
- qasja në burimet e informacionit dhe kërkimi i informacionit duke përdorur mjete për gjetjen dhe zbulimin e informacionit;
- vlerësimi kritik i informacionit mediatik brenda kontekstit specifik dhe më të gjerë;
- përdorimi i mediave dhe ofruesit e tjerë të informacionit për të promovuar liritë themelore dhe mësimin gjatë gjithë jetës;
- etika mediatike dhe etika e informimit;
- standardet ndërkombëtare, liria e informimit dhe kufizimet e nevojshme për të parandaluar shkeljen e të drejtave të tjerëve (gjuha e urrejtjes, shpifja, privatësia);
- pritshmëritë nga mediat dhe ofruesit e tjerë të informacionit (pluralizmi dhe diversiteti).¹⁷

Për të mundësuar zhvillimin e suksesshëm të kompetencave të arsimit mediatik midis nxënësve, trajnimi duhet të kontribuojë gjithashtu që mësuesit të kuptojnë ndërveprimin e nxënësve me mediat dhe të fitojnë aftësi se si të maksimizojnë përdorimin e mediave të ndryshme në mësimdhënie, duke kontribuar jo vetëm në arritjen e qëllimeve njohëse në mësimdhënie (përmes aplikimit të mendimit kritik dhe analitik), por edhe në përmirësimin e zhvillimit social të nxënësve (përmes respektimit të pikëpamjeve dhe perspektivave të ndryshme), pa prishur zhvillimin e tyre emocional (përmes mbrojtjes së të dhënave personale dhe rezistencës ndaj manipulimit emocional).

¹⁷ Përshtatur nga Wilson, Carolyn, Grizzle, Alton, Tuazon, Ramon, Akyempong, Kwame, Cheung, Chi Kim (2011). *Media and information literacy curriculum for teachers*. [https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000192971].

